



INSTITUCIONET E PËRKOQSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT DHE
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

MINISTRY OF ENVIRONMENT
AND SPATIAL PLANNING

MINISTARSTVO SREDINE I
PROSTORNOG PLANIRANJA

Komuna e Kamenicës

Analiza Hapësinore



ANALIZA HAPESINORE

ANALIZA HAPESINORE

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Instituti për Planifikim Hapësinor

Ky dokument është rezultat i punës së përbashkët
të Institutit për Planifikim Hapësinor
dhe zyrtarëve të Komunës së Kamenicës

Gusht, 2007

ANALIZA HAPESINORE

Hyrje

Analiza hapësinore e territorit të një komune ka për qëllim të paraqesë gjendjen në vendbanimet e asaj komune shikuar nga aspekti ekonomik, social dhe mjedisor. Analiza hapësinore i tregon vendet ku ka probleme që lidhen me shfrytëzimin e hapësirës dhe probleme tjera, pastaj cili është trendi i zhvillimeve në hapësirë (pozitiv apo negativ) dhe në cilat vende është ai i shprehur. Në analizën hapësinore bëhet një krahasim i gjendjes së tanishme të zënies së hapësirës (tokës) me gjendjen që ka qenë para një periudhe të caktuar kohore, tregohet dinamika, shpejtësia e kësaj zënie dhe parashikimi se çka do të ndodhë në të ardhmen nëse vazhdon dinamika aktuale e zënies së tokës. Analiza hapësinore rekomandon zgjidhje për problemet dhe për ndalimin e trendëve negative të zhvillimeve në hapësirë. Ajo gjithashtu analizon ndikimin hapësinor të planeve dhe projekteve konkrete zhvillimore për të ardhmen që i ka komuna duke konstatuar se a do të jetë pozitiv apo negativ ai ndikim dhe a është zgjedhur hapësira adekuate për realizimin e projektit apo jo.

Kosova sot po përballlet me probleme të shumta të fushave dhe karaktereve të ndryshme. Gjatë procesit të përpilimit të planit hapësinor të Kosovës, janë identifikuar 12 çështje më të rëndësishme dhe më aktuale sot në Kosovë, të cilat kërkojnë zgjidhje sa më të shpejtë. Ato janë :

1. Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme
2. Varfëria e lartë dhe në rritje
3. Depopullimi i vendbanimeve
4. Shërbimet e ulëta shëndetësore dhe arsimore
5. Degradimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore
6. Banimi
7. Humbja e tokës bujqësore
8. Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni
9. Shkalla e lartë e ndotjes dhe degradimi i mjedisit
10. Shfrytëzimi joracional i resurseve natyrore
11. Zhvillimi i pabarabartë ekonomik
12. Vendbanimet, shërbimet dhe infrastruktura

Çështjet e listuara më sipër janë rezultat i takimeve të shumta me grupet ndërministrare, janë gjithashtu rezultat edhe i takimeve publike të organizuara në disa qendra të mëdha të Kosovës. Në të gjitha këto takime u arrit pajtueshmëri e plotë me listën e propozuar, për të cilat në mënyrë urgjente planet komunale e në këtë drejtim edhe Plani Hapësinor i Kosovës do të duhej të ofronin zgjidhje. Ky ishte momenti kur u propozua që së bashku me strukturat komunale të gjitha komunave të fillohet puna në analizat hapësinore komunale në mënyrë që të verifikohen dhe të rajonalizohen çështjet e listuara të cilat për rezultat përfundimtar do ta kenë pasqyrën më reale të shtrirjes së këtyre problemeve në territorin e Kosovës.

Në këtë drejtim dhe në bashkëpunim të ngushtë me përgjegjësit komunal, kemi përfunduar analizën hapësinore të çështjeve për Komunën e Kamenicës. Ky material është një bazë e mirë e të dhënave shumë të nevojshme për hartimin e planit zhvillimor komunal, të cilat në vete duhet gjithashtu të përmbajnë udhëzime dhe zgjidhje edhe për problemet eventuale specifike komunale që nuk janë temë e kësaj analize.

ANALIZA HAPESINORE

Përmbajtja

Profili komunal-----	7
Pozita gjeografike, veçorit fiziko natyrore, gjeologjike dhe karakteristikat e terrenit-----	7
Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme-----	17
Varfëria e lartë dhe në rritje -----	21
Depopullimi i vendbanimeve -----	23
Shërbimet e ulëta arsimore dhe shëndetësore-----	25
Degradimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore -----	29
Humbja e tokës bujqësore -----	37
Banimi -----	43
Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni -----	46
Ndotja dhe degradimi i mjedisit -----	51
Shfrytëzimi jo racional i resurseve natyrore -----	54
Zhvillimi i pabarabartë ekonomik -----	55
Infrastruktura dhe shërbimet -----	62
Problemet dhe mundësitë -----	73
Treguesit dhe kriteret e për vlerësim -----	76
Përgjegjësit dhe bashkëpunëtorët -----	78

ANALIZA HAPESINORE

Profili komunal

Në vitin 1959 Kamenica fiton statusin Komunë, si njësi e barabartë me komunat tjera në vend.




Pozita gjeografike

Komuna e Kamenicës shtrihet në Lindje të Kosovës. Kufizohet në Jugë-Perëndim me komunën e Gjilanit, në Perëndim me komunën Novobërdës si dhe në Veri-Perëndim me Prishtinën. Në Veri me Komunën e Medvegjës dhe Leskovcit, në Lindje me Vranjën dhe në Lindje dhe Jugë-Lindje me Bujanocin. Sipërfaqja e K. Kamenicës është 523 km².

Pozita gjeografike e K. Kamenicës është perimerike në skajin me Lindor të Kosovës por është urë lidhëse në mes të Kosovës dhe komunave të Serbisë Jugore kryesisht të banuara me shqiptar. Nëpërmjet magjistrales Gjilan-Bujanoc, lidhet me qendrat tjera të Kosovës. Gjilani ndodhet në largësi 30 km, ndërsa Prishtina 75 km nga Kamenica. Me Prishtinën mund të lidhet edhe me rrugë më të shkurtër, nëpër Novobërdë dhe Llabjan, ku në të dy drejtimet rruga shkurtrohet për 20-25 km. Stacioni më i afërt Hekurudhor është në Ferizaj dhe Bujanoc.

Aeroporti më i afërt është ai i Prishtinës 90km dhe i Shkupit 130km.



ANALIZA HAPESINORE

Karakteristikat e terrenit

Terreni i Komunës së Kamenicës është kodrinor- malor me disa lugina rreth lumenjve, me tokë aluviale shumë të përshtatshme për perimtari, dhe kultura tjera bujqësore. Këto shtrihen në pellgun e lumenjve Krivareka, lumit të Desivojcës dhe Hogoshtit nga ana veriore, kurse pjesa jugore shtrihet rreth lumit Anamorava. Shprehur në përqindje territori i Komunës së Kamenicës është: 60 % kodrinor-malor dhe 40 % i rrafshët.

Kushtet klimatike – Komuna e Kamenicës ka klimë të mesme kontinentale , me verëra të nxehta dhe dimra të ftohtë. Temperatura mesatare e janarit është -1°C , ndërsa ajo e korrikut 21.50°C . Temperaturat maksimale absolute janë në muajin gusht 37°C , kurse minimale absolute janë në janar -32°C . Reshjet atmosferike mesatarisht sillen prej 499 – 675 l/m². Lartësia më e ulët mbidetare është 380m te “Dheu i bardhë” , kurse ajo më e larta është 1223 m te “ Guri i zi”. (f. Tërsten)

Lagështia e ajrit – vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 76.8%. Muaji më i thatë është gushti 66%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84 %.


Reshjet – Sasitë mesatare vjetore të reshurave në komunën e Kamenicës arrin 596l/m², ndërkaq në zonën malore shtohen në 800 l/m².

Muajt më të pasur me shi janë nëntori dhe maji me 76.1 dhe 71.9 l/m², kurse në viset malore muaji i dhjetorit me 101.0 l/m². Muaji më i thatë është korriku dhe gushti.

Erërat – Në komunën e Kamenicës erërat më të shpeshta janë ato veriore me dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me, kurse shpejtësia mesatare e erës është 3m/sek.

Hidrografia – Ka një rrjet të dendur hidrografie, por më të rëndësishmit janë: Lumi Krivareka, lumi i Hogoshtit dhe lumi i Desivojcës . Të gjithë këta lumenj derdhen në lumin Morava. Në këtë komunë është akumulacioni ujqor liqeni në fshatin Ruboc. Lumenjtë e Kamenicës rrjedhje më të mëdha kanë gjatë muajit shkurt ,mars dhe maj, kurse rrjedha më të vogla gjat muajit gusht dhe shtatorë.

Karakteristikat morfologjike – Territori i hulumtuar i takon pjesës fundore të masës Serbo-maqedonase që karakterizohet me dislokacione regjionale të shkallës së lartë në drejtim të cilave janë kryer lëvizje orogjene. Përveç kristalinitetit të lartë në reshpet kristalore kemi dhe serinë rrudhosëse, strukturart thyese. Këtu janë vërejtur tri dislokacione kryesore të cilat kanë shërbyer si bazë për vijëzimin e strukturës tektonike të basenit. Dislokacioni i parë komponon ultësirën e lumit të Krivarekës në drejtim VP- JL, kurse i dyti lumi i Hogoshtit në



drejtim VJ. Linja e tretë dislokative shtrihet prej Karaqevës së epërme kah rreshet kristalore deri në gryken e lumit të Hogoshtit në drejtim VL- JP. Baseni i Krivarekës shtrihet në pjesën e skajshme lindore të regjionit, është shumë i vogël madje dhe shumë i ndarë në pjesë, prandaj ka një formë të pa rregullt. Depresioni i Moravës është regjion tektonik i ulur i cili është i mbushur me sendimente horizontale dhe transgresive të miocenit, sendimenteve liqenore me qymyr të pliocenit.

Toka dhe llojet e sajë

Territori i komunës së Kamenicës është territor kodrinor malorë me disa lugina rreth lumenjve, me tokë aluviale shumë të përshtatshme për pemëtari dhe kultura tjera bujqësore. Këto lloje të tokave shtrihen në pellgun e lumenjve Krivareka, lumit të Desivojcës dhe Hogoshtit nga ana veriore, kurse pjesa jugore shtrihet rreth lumit Anamorava. Shprehur në përqindje territori i komunës së Kamenicës është 60% kodrinoro malorë dhe 40% i rrafshët. Komuna e Kamenicës në krahasim me sipërfaqen e përgjithshme posedon sipërfaqe bujqësore rreth 55% ose 28.984 ha, ka një tokë me strukturë të ndryshme dhe veti po ashtu të ndryshme. Në krahasim me sipërfaqen bujqësore rreth 45% ose 13.043 ha e sipërfaqes është tokë ngjyre kafe mbi flish, aluviale 22% ose 6.376 ha, rankere 18% ose 5.217 ha, smonicë 15% ose 4.348 ha. Nga sipërfaqja e tokës bujqësore 16.221 ha janë ara, 9.246 ha kullosa, 3297 ha livadhe, 200 ha pemishte dhe 20 ha vreshta.

Karakteristikat pedologjike-

Tiparet themelore të regjionit të Anamoravës janë krijuar në kohën e oligomiocenit, respektivisht gjatë kohës së krijimit të sistemit të maleve Dinarike dhe të maleve të Sharit. Çrregullimet e atëhershme tektonike janë manifestua me shkarje të fuqishme dhe me uljen e ternit e që kanë vazhduar edhe në fazën vijuese gjeologjike të formimit të relievit pasakullnajor. Pas rrjedhave të liqeneve neogjen, që sipas hipotezave ka ndodhur kah fundi i deliviumit dhe pas tharjeve të sipërfaqeve të cilat i ka përfshirë liqeni i Kosovës, relievi i parë i formuar i regjionit të Anamoravës me ndikimin e faktorëve të jashtëm, veçanërisht me veprimin e lumenjve dhe të përrenjve si dhe të reshjeve atmosferike është sjellë në gjendje të tanishme. Në regjionin e Kamenicës – Anamoravës nga aspekti gjeografik dhe ai morfologjik mund të veçohet: Zona bregore valore me lugina lumenjsh, që me veprimin e lumenjve dhe të përrenjve është ndarë në disa pllaja të vogla ose të mëdha dhe zona e rajonit kodrinoro- malore, që nga aspekti geomorfologjik, gjenetik dhe ai klimatik dallohen në mes tyre. Për nga përbërja dhe vlera që kanë për prodhimin bujqësorë, tokat në tërësi dallohen në mes tyre. Në luginat e lumenjve dhe në pllajat e ndryshme si dhe në tarracën abrazive nëpër kindet e zonave kodrinoro malore dominon tokë e thellë, më kompakte dhe për prodhime bujqësore më e përshtatshme, kurse në zonën kodrinoro malore dominon kryesisht tokë e cekët dhe për bujqësi e pa përshtatshme, respektivisht e përshtatshme për zhvillimin e kullosave dhe pylltarisë. Pra regjioni i Anamoravës dallohet nga komunat tjera me një pedologji më homogjene.

Flora dhe Fauna

Ekziston një florë dhe faunë shumë e begat, si p.sh. ajo karakterizohet me nr. të madh të bimëve si të atyre të larta drunore gjetherënëse si: ahu, bungu, qarri, blini, akacia, shkoza, frashër etj. Po ashtu po thuaj se të gjitha pemët frutore të grupit farorë, grupit bërthamor, arrorë si dhe të atyre manore - dredhëza, manaferra, mjedra etj. Gjithashtu është mjaft e pasur me bimë barishtore të lloj-llojshme, të gjitha llojet e drithërave (gruri, tërshëra, elbi, misri etj.); Nga shtazët e egra takojmë: derri, dhelpira, ujku, lepuri etj. Prej shpezëve të egra: pula e egër, fëllënza, skifteri, huti etj. Sa i përket faunës së ujit, lumenjtë janë të pasur me peshq si që janë trofta, ngjala etj. Po ashtu ka edhe zvarranik si gjarpërinj, bolla etj. Bimë foragjere (jonxha, tërfili i kuq, telishi etj.). Sa i përket faunës, po ashtu është e pasur si me kafshë të egra si dhe kafshë të tjera, çka është një potencial i mirë për gjueti.

Resurset natyrore

Komuna e Dardanes sipas vëllimit dhe llojlojshmërisë së xeheve minerale bënë pjesë në radhën e komunave të pasura dhe paraqet faktorin kryesor për zhvillimin e komunës. Xehet më të rëndësishme minerale të metaleve dhe jometaleve janë:

- *Magnezitet* – në lokalitetin Strezoc në largësi prej 14 km nga Kamenica, ndodhet vendburimi i xehes së magnezitit. Në këtë vendburim dallohen magnezitetet masive, ku deri para luftës janë eksploatuar magnezitetet nyjor dhe në formë shiriti – hulumtimi i të cilave është në vijim e sipër. Rezervat e magnezitit janë rreth 1.3 milion tonelata, kurse ata nyjor dhe në formë shiriti rreth 4.5 milion tonelata. Kanë zbatim të madh në industri, si pleh artificial, në industrinë e letrës, si ushqim i kafshëve dhe si material izolues.

- *Granitet e kaolinizuara (Kaolini)* – i vetmi vendburim i xehes së granitit të kaolinizuar në Kosovë gjendet në fshatin Karaqevë. Rezervat e kësaj xehe janë rreth 3.5 milion tonelata . Përdorimi i kaolinit është treguar shumë i përshtatshëm për prodhimin e pllakave të qeramikës dhe për enë porcelani.

- *Bentonitet* – paraqiten në këto lokalitete Drenoc, Karaqevë, Rogaqicë, Kolloleq, Tomancë. Rezervat e bentonitit në Karaqevë janë rreth 1.2 milion tonelata. Kanë përdorim të gjerë në industrinë ushqimore, si dhe për prodhimin e tullave, tjegullave, blloqeve e tjera.

- *Kuarcitet* – shfaqen në lokalitetin e Strezocit, në afërsi të xeherores së magnezitit. Rezervat e konstatuara janë rreth 2.5 milion tonelata.

- *Tufet* – shfaqjen e tufëve kemi në lokalitetet e Karaqevës dhe të Topanicës rreth 5 km në afërsi të Dardanes. Gjejnë aplikim të përshtatshëm në industrinë e çimentos, për prodhimin e agregateve të lehtë dhe për blloqe të zgavruara cilësore të betonit, tullave, tjegullave, blloqeve etj. Rezervat janë rreth 665.000 tonelata.

- *Deltina* - në Komunën tonë kemi vendburimin e deltinës në fshatin Korminjan të Poshtëm, ku ka qenë i vendosur edhe seperacioni.

- *Gëlqerorët* – vendburime të gëlqerorit takohen në komunën tonë të cilat mund të shfrytëzohen dhe përdoren si agregate gurore për mbushje të rrugëve. Gëlqeror kemi edhe në fshatin Bolec me përbërje të CaCO_3 nga i cili përfitohet gëlqerja e shuar ose gëlqere në formë të pluhurit.

- *Mermerët* – masa relativisht të mëdha të mermerit janë hasur në veri-perëndim të Kamenicës. Kanë veti të mira fiziko-mekanike. Përbëhen nga kalci dhe mikat. Kanë ngjyrë të bardhë deri në të përhimët të çelur. Gjejnë aplikim në industrinë e ndërtimit për mbushjen e rrugëve, si agregat betoni etj.

- *Granitet* – në veri të fshatit Hogosht ndeshet vendburimi i granitit. Rezervat e vlerësuara janë rreth 1.800 tonelata.

- *Feldshpatet* – shfaqjet e feldshpateve janë konstatuar në afërsi të fshatit Vriqec dhe Shipashnicë e Epërme. Hulumtimet orientuese kanë dëshmuar se ka rezerva të kësaj lënde cilësore.

- *Andezitet* – në fshatin Krilevë kemi vendburimin e andeziteve të cilët kanë rëndësi të madhe në industrinë e ndërtimit. Lokacioni karakterizohet me rezerva të mëdha ndërsa të hulumtuara janë rreth 635.000 m³.

- *Rërat dhe zhavorret* – luginat aluviale të Komunës së Dardanes janë të pasura me rëra dhe zhavorre. Rëra e përzier me lym duhet të pastrohet dhe i plotëson kushtet për shfrytëzim në ndërtimtari. Për at është investuar në seperacione. Lënda e parë për rërë dhe zhavorr është e përqendruar në brigjet e lumenjve të Krivarekes, Hogoshtit, Desivojces.

- *Granatet* – takohen në bashkëshoqërim me mikashistët dhe shumë lehtë ndahen nga to. Madhësia e kokërrzave sillet prej disa cm deri në 4 cm. Mostrat kanë treguar se granatet

përbërjen më të madhe e kanë nga almandini. Vendburimi i granateve të fshatit Lisockë është eksploatuar për firmën „Katran” nga Zagrebi.

- *Antimoniti* – është konstatuar në rrethinën e Kranidellit. Xehja e antimonitit lajmërohet i lidhur me damarët kuarcite të cilat janë të lokalizuara në zonat me alterim të fortë të graniteve, respektivisht kaolines. Trashësia e damarëve kuarcite sillet prej disa cm deri në 4 m. Xehen e antimonitit përveç damarëve kuarcite e përcjellin edhe bariti dhe kalçiti. Përbërja kimike e xehes së antimonitit është : Sb-14.04, Pb-gjurmë, Zn-0.38, As-1.02. Rajoni paraqet perspektiv për hulumtimet e ardhshme.

Ndërtimi gjeologjik i rajonit të gjerë

Regjionin e gjerë të vendburimit e ndërtojnë këto njësi litologjike:

1. Rreshpet kristalore të grupit të parë
2. Formacionet terciare-miocene
3. Granite, pegmatite dhe apsite
4. Tufet andezito-dacite
5. Mermerët dhe gëlqerorët e mermerizuar
6. Produktet e quaternarit

1. Rreshpet kristalore të grupit të parë

Pjesa periferike e pellgut Terciar të Krivarekes, ndërtohet nga rreshpet kristalore të masës së Rodopeve. Seria e rreshpeve kristalore është shumë heterogjene dhe në ndërtimin e saj marrin pjesë rreshpe të ndryshme me kristalizim të ulët, si: rreshpet sericitike, kuarc-sericitike, albito – mikore dhe rreshpet e gjelbra të cilat përbëjnë shkëmbinjtë themelor të rajonit të gjerë. Në të cilat në formë të damarëve ose thjerrëzave të dimensioneve të ndryshme janë ndërfutur mermerët, granitet dhe amfibolitet. Moshja e shkëmbinjve kristalor të kësaj serie është diskutabile.

Në analogji me formacionet përreth ka mendime se shkëmbinjtë e kësaj serie i përkasin moshës Paleozoike. Rreshpet kristalore paraqesin shkëmbinjtë më të vjetër në territorin e Kosovës dhe shtrihen në pjesët e skajshme lindore të saj. Rreshpet kristalore të këtij grupi paraqesin pjesën më të vjetër të këtij terreni. Në aspektin litologjik paraqesin ortoshkëmbinjtë dhe para-shkëmbinjtë.

Ortoshkëmbinjtë janë të përfaqësuara nga ortognajset, rreshpet amfibolike, amfibolet, rreshpet epidot-amfibolike dhe eklogitet.

Parashkëmbinjve iu takojnë paragnajset, metakuarcitet, mikashistet dhe leptinolitet. E gjithë seria e rreshpeve kristalore është e përshkruar nga stoqet granite dhe apofize.

Në tërë territorin e hulumtuar rreshpet kristalore lajmërohen në forma të vogla ose të mëdha të masave pykëzore dhe thjerrëzore të cilat janë të futura në plutonin granitik.

Paragnajset së bashku me mikashistet përbëjnë pjesën kryesore të masës kristalore të parashkëmbinjëve. Kjo seri e rreshpeve kristalore përfaqësohet nga gnajset kokërrmëdha mikore dhe nga gnajset kokërrimëta biotitike, metakuarciteve, leptinoliteve dhe mikashiste. Të gjithë këta shkëmbinjtë në aspektin horizontal dhe vertikal pësojnë ndryshime.

Gnajset kokërrmëdha rëndom janë të përhimëta me përbërje, kuarci, feldshpati dhe mika, ndërsa nga përbërësit me ngjyrë lajmërohen hornblenda. Strukturat janë granoblastike dhe porfiroblastike .

Metakuarcitet janë shkëmbinj të fortë me ngjyrë hiri, të cilët janë të lidhur me gnajset amfibolike. Në këta dominojnë shpeshherë kuarci dhe biotiti, nga njëherë edhe feldshpati.

Mikashistet dhe leptinolitet shtrihen në anën veriperëndimore të terrenit. Në pjesën veriore gjinden tipet e mikashisteve me pak feldspat ose pa te. Mikashistet në afërsi të masës granite kalojnë në leptinolite të cilat përbëhen nga muskoviti, biotiti, kuarci dhe pak feldspat. Në to dominojnë biotiti për ndryshim nga mikashistet.

Ortoshkëmbinjëve i takojnë ortognajset dhe shkëmbinj të amfibolik. Ortognajset përbëhen nga kuarci, feldspati, biotiti dhe muskoviti. Kuarci shpeshherë dominon mbi mineralet tjera. Feldspati përbëhet nga pllajjioklazet dhe mikrokлина. Strukturat janë granoblastike dhe porfiroblaste. Këto gnajse nuk paraqesin trupa individual, por vetëm ndërtim të zonave të gjata të cilat ndërrohen me rreshtet kristalore .

Rreshtet amfibolike dhe amfibolitet kanë shpërndarje ma të vogla se sa gnajset. Ndërmjet tyre dallohen rreshtet amfibolike, eklogitet, rreshtet epido-amfibolike. Përbërësit kryesor janë hornblenda e gjelbër, kuarci, pllajjioklazet me shumë granate, sfeni dhe apatiti. Prej mineraleve në eklogite takohet granati, afër të cilit takohet hornblenda dhe biotiti. Ndërsa rreshtet epido-amfibolike përmbajnë epidot me sasi të madhe, shumë herë më shumë se hornblenda .

Shkëmbinj të amfibolik paraqesin shkëmbinj magmatik bazik të metamorfizuar dhe gjithherë përcillen në pjesën periferike të masivit granit. Këta shkëmbinj më së shpeshti lajmërohen në formë thjerrëzore, trashësia e të cilëve sillet rreth disa dhjetëra metrave. Sikur ortognajset edhe këta shkëmbinj kanë origjinë magmatike. Të gjitha rreshtet kristalore të cekura kanë kristalinitet dhe shkallë të lartë të metamorfizimit.

2. Formacionet e terciarit-miocenit

Sedimentet e Terciarit të ujërave të ëmbla përfshijnë hapësirën e madhe në territorin e hulumtuar. Ato mbushin një depresion tektonik të formuar me shkarjen e terrenit për gjatë drejtimit dislokativ në pjesën periferike të pellgut. Në bazë të dhënave mbi këto formacione nga autor të ndryshëm (M. Protiqi, B. Millovanoviqit) kanë ardhur në përfundim se këto formacione ndahen në dy pjesë në të poshtme dhe të sipërme. Këto shtresa janë identike me disa shtresa të basenit të Terciarit të Vranjes në të cilat janë gjetur mbeturinat micromarix fluorensismus-Lartet të cilat i takojnë miocenit të mesëm dhe të sipërm.

Pellgu sedimentar i terciarit të Krivarekës në aspektin litologjik ndahet në tri pjesë: - e poshtme ose bazale, të mesme dhe të sipërme.

Pjesa e poshtme dhe e sipërme janë të ndërtuara nga rëra, zhavorri dhe mbeturinat të cilat janë të lidhura me argjilë ranore. Pjesën e mesme e ndërtojnë mergelet me përbërje të shkëmbinjve ranor.

Sedimentet Terciare të serisë së poshtme – bazale ndërtojnë pjesën periferike të pellgut. Në pjesën veriore dhe lindore në periferi të pellgut, shfaqen edhe rreshtet kristalore. Marrëdhënia e serisë bazale përkundër formacioneve periferike është transgresive dhe pjesërisht është e përshkuar me konglomerate bazale. Kjo pjesë e serisë në Karaqevën e Poshtme – Epërme fillon me konglomerate bazale të cilat pjesërisht janë zbuluara, ndërsa në kontaktin direkt me rreshtet gjinden rërat dhe zhavorret kokërrmëdhenj. Konglomeratet janë të çimentuara dobët.

Në shumë pjesë të poshtme ekziston materiali i pastër, rërat plotësisht kalojnë në argjilë ranore kokërrimët. Nganjëherë edhe rërat janë dobët të lidhura dhe pjesërisht kalojnë në ranor argjiloro-mergelor. Shfaqen me ngjyrë të verdhë apo të verdhë në të gjelbër. Në pjesë perëndimore të këtij territori, seria bazale është e ndërtuar nga aglomeratet të cilat dominojnë në pjesën veriore për ndryshim nga ajo jugore, në të cilët lajmërohen rërat kokërrimëta dhe kokërrmëdha të pastra ose argjilore, gjegjësisht konglomeratet dhe ranorët. Kjo përbërje më së miri shihet në mes të Topanicës dhe Koretinit. Shtrirjet kryesore të serisë bazale janë të orientuara kah JL dhe VP. Pjesa e mesme e serisë Terciare është e ndërtuar nga shtresat e holla të përhimëta të mergeleve pllakëzore, të cilat janë të ndërtuara në rrethinën e Karaqevës së Poshtme dhe të Epërme .

Ndërrimi i mergeleve dhe ranorëve si dhe zhdukja graduale e këtyre të fundit, tregon kalimin nga pjesa e mesme në të sipërmen të serisë Terciare, që më së miri shihet mes Topanicës dhe Bllatës së vjetër. Shtrirja gjenerale e serisë mergelore është kah V.P. në disa zona me drejtim të shtrirjes kah JP, JL dhe VL.

Mergelet ndërtojnë zonën në drejtim VL dhe JP me gjerësi mesatare prej 3-3,5 km. Ky është në të vërtet zona në mes të Karaqevës së Epërme dhe Breznicës në VL si dhe Topanicës e Domorocit në JP. Në mes të Karaqevës së Poshtme – Epërme dhe Rogoqicës mergelet shtrihen mbi pjesën bazale të serisë Terciare me të cilën ndërtohet sinklinalja. M.Pavloviqi në mergele ka gjetur faunën OSTRAKODA në mes Topanicës dhe Bllatës.

Pjesa e sipërme e serisë Terciare në pikëpamje litologjike është e paraqitur nga argjilat, rërat kokërrimëta dhe kokërrmëdha me ngjyrë të verdhë dhe të verdhë në të kuqe në të cilat lajmërohen shtresat e argjilave ranore, gjegjësisht ranorëve dhe mergeleve. Në pjesën më të lartë lajmërohet zhavorri dhe mbeturina të cilat ndërrohen me rërat dhe argjilat kokërrmëdha. Ky material i gjerë paraqet aglomeratet të cilat tregojnë për mbushjen e shpejt të pellgut dhe fazën përfundimtare të regresionit.

Pjesa e sipërme e serisë së miocenit shumë mirë është e zhvilluar në mes të lumit të Hogoshtit dhe Desivojcës, si dhe në veri të Kolloleqit dhe Desivojcës. Në këtë seri takohen ranorët e bardhë të stratifikuar të cilët përdoren si material ndërtimor .

Në pellgun e sedimenteve të Tercierit të Krivarekës në disa vende lajmërohet thëngjilli. Në Karaqevën e Poshtme në përroin e Karabateve kemi shfaqje të thëngjillit, ku shtresa është me trashësi 0.8 m dhe shtrihet mbi ranorët e përhimët dhe të gjelbër.

Shfaqja tjetër e thëngjilli lajmërohet në fshatin Bosce dhe gjirin mbi Malitërnovc. Në Bosce trashësia e thëngjillit sillet deri në 2 m. Shfaqje të këtilla kemi edhe në Shipashnicën e Eperme te përroi i Barës dhe i Stanit, te përroi i Muqivercit etj. Përgjatë periferisë së pellgut të Tercierit relativisht lajmërohet zona e gjerë nyjore shpeshherë me lëvizje intensive e cila në disa pjesë prezantohet me argjilën bentonite. Në këtë Terciar janë karakteristike kënetat e izoluara të cilat kanë qenë të vërshuara nga ujërat e pellgut Terciar të Krivarekes. Në vendet ku kanë qenë kushtet e mira është kryer kaolinizimi i graniteve nën ndikimin e ujërave kënetor.

3. Granitet, pegmatitet dhe applitet

Granitet kanë shtrirje konkordante në serinë e rreshpeve kristalore. Këta shkëmbinj shpesh herë përbëhen nga kuarci, feldspatet dhe mikat. Kanë strukturë granitike, shpesh herë edhe porfiroide, ndahen në dy tipe: Granitet e vjetra dhe Granitet e reja.

Granitet e vjetra - janë të gnajsifikuara, kokërr mesme me ngjyrë të verdhë. Rreshpëzimi në shumicën e rasteve është i shprehur mirë. Në shumë vende në ta shihet foliacioni primar me elemente të rënies 90/30°. Këto granite pjesërisht janë intruzive, ndërsa pjesa më e vogël paraqet granite që kanë mbetur me granitizimin e rreshpeve. Prej përbërësve kryesor janë: kuarci, feldspatet dhe mikat. Strukturat janë granitike, shpeshherë edhe porfiroide.

Granitet e reja - i takojnë kompleksit magmatik të intruzionit granitik. Meqenëse masa e granitit intruziv nuk ka përfunduar me ngurtësimin e masës kryesore, mirëpo edhe më vonë kanë ndodhur edhe faza të mëvonshme të cilat si produkt kanë formimin e graniteve të reja. Këto granite janë kokërrimët me ngjyrë të përhimët dhe para rreshpëzim. Analizat mikroskopike tregojnë për prezencën e feldshpatit, kuarcit, me sasi të vogël të biotitit dhe muskovitit.

Shpëtëzimi shpeshherë është planar. Kufiri në mes të graniteve të reja dhe të vjetra gjithëherë është i kuart. Vjetërsia e këtyre graniteve është e lidhur për fazën orogjene.

Plutoni granitik i Bujanocit është i pasur me komponente të cilat janë të afërta me pegmatite dhe damarëve apлите si damar ekuivalent të magmës granite. Këta trupa planar shfaqen në formë damarore, si dhe në forma jo të rregullt të zgjatura. Trashësia e tyre sillet disa metra. Pegmatitet përfaqësohen nga: kuarci, feldshpati dhe muskoviti. Damarët apлите janë më të hollë se pegmatitet dhe kuarcitet. Janë me trashësi më të vogël se 0.2 m dhe depërtojnë në drejtime

të ndryshme. Strukturat janë kokërrimëta, ngjyra e graniteve është zakonisht e bardhë deri në të verdhë.

4. Tufet andezito-dacite

Në rrethinën e Topanicës janë vërtetuar dukuri të tufeve të cilat eksploatohen dhe përpunohen në industrinë e çimentos. Shfaqja e tufeve në këtë pjesë të pellgut të Terciarit të Krivarekës, na tregon se ka ndodhur aktivitet vullkanik. Tufet kanë trashësi mbi dy metra, dhe janë të lidhur me pjesën e sipërme të serisë së miocenit, respektivisht për facien e ranorëve, argjilave, mergeleve dhe zhavorreve. Përveç tufeve të cilat janë të interstratifikuar në shtresat sedimentare të miocenit lajmërohen edhe argjilat tufore dhe ranore. Tufet e Topanicës janë me ngjyrë të bardhë të fortë dhe kompakte. Në këto tufe shihen shpetëzimet dhe plasaritjet përgjatë së cilave lajmërohet limoniti, për çka ndonjëherë kanë ngjyrë të verdhë-kuqe.

Në rrethinën e fshatit Topanicë tufet lajmërohen në dyshtemenë argjilore mbi të cilën janë zhavorret. Në rrethinën e fshatit Koretin lajmërohen tufet me ngjyrë të verdhë –kuqe me gjatësi 5-10 m.


5. Mermerët dhe gëlqerorët e mermerizuar

Mermerit dhe gëlqerorët e mermerizuar gjendet në veri-perëndim të Dardanes. Mermerët janë të fortë, kanë strukturë kokërrzore. Përbëhen prej kalciti dhe me sasi të mikave dhe kuarcit. Kanë teksturë bankovite, rrallë rreshtëzore. Mermerët e kësaj anë me anë të vrojtimit makroskopike, shfaqen me përmasa dhe trashësi të ndryshme më së shumti deri në 10 m. Zakonisht janë të shoqëruar me rreshtëzime amfibolike dhe sericit – biotike. Përbëhen kryesisht prej kalcitit dhe shoqërohen me paraqitje të vogla të kalkshisteve. Kanë ngjyrë të bardhë, por paraqiten edhe me ngjyrë të përhimët në të çelur. Kanë strukturë kokërrzore. Kryesisht përmbajnë kalcit dhe shumë pak minerale të tjera. Kalkshistet paraqiten në mermere me trashësi më të madhe deri 1m. Përbëhen prej kuarcit kokërrimët, sericitit dhe masës karbonatike.

6. Produktet e kuaternarit (q)

Në fushën e Moravës së Binçes produktet e kuaternarit kanë shtrirje të madhe. Gjenezat dhe litologjia e këtyre depozitimeve është e ndryshme. Përveç krijimeve kontinentale janë të pranishme edhe sedimentet liqenore. Këto produkte mbulojnë pjesët e rrafshëta dhe luginat dhe janë të ndërtuara nga sedimentet aluviale, proluvioneve dhe deluvioneve.

ANALIZA HAPESINORE



► Harta
gieologo-
tektonike e
Rajonit të
Kamenicës


ANALIZA HAPESINORE

Ndërtimi tektonik

Territori i komunës së Kamenicës i takon zonës qendrore të maleve të vjetra Rodope. Sikur në çdo vend edhe këtu kanë ndikuar dhe ndikojnë fuqitë tektonike endogjene dhe ekzogjene. Me ndikimin e këtyre fuqive janë krijuar trajtat themelore të relievit, ultësirat e lartësirat. Në mbarim të Paleozoikut gjatë periodave të kembrianit dhe permit me ndikimin e fuqive tektonike, korja e tokës është qarë, ku prej pjesëve të saja të ngritura janë formuar malet e vjetra. Prej këtyre dallohen malet me lartësi të mesme: Guri i Zi 1274 m, Maja e Velegllavës 1181m, Rrafshi i Lajthijave 1163 m, Kika 1154 m, Tepja 1081 m, Pllania 1066 m etj. Në gjysmën e Tercierit në periudhën e oligocenit kanë ndodhur lëvizjet e reja tektonike ku disa prej këtyre maleve janë fundosur, e disa janë ngritur por nuk kanë pësuar ndonjë ndryshim të madh në formën e tyre. Këto qarje në këtë kohë kanë shërbyer si zona për shpërthime të fuqishme vullkanike. Këto vullkane kanë pushuar gjatë kohërave të ndryshme gjeologjike, kurse kupat e krateret e tyre janë shkatërruar nga fuqitë e jashtme. Si argumentim i ekzistimit të vullkaneve na vërtetojnë shkëmbinjtë e ndryshëm vullkanik (efuziv), si tufet në veri të fshatit Topanicë deri në fshatin Koretin, dacite-andezite që gjenden në V.P të pellgut në lokalitetin e Krilevës. Në pjesët e fundosura është krijuar pellgu i lumit Krivareka (tercier-miocen) me reliev kodrinoro-malor me lartësi mbidetare deri në 600 m. Këtë pellg e përbëjnë edhe disa lugina të lumenjve siq janë: lugina e lumit të Hogoshtit, Desivojcës, Kremenatës, ajo e Moravës së Binçës. Në bazë të këtyre fuqive është pjerrtësuar terreni dhe zbrit kah luginat.

Territori i hulumtuar karakterizohet me dislokacione regjionale të shkallës së lartë në drejtim të cilave janë kryer lëvizje orogjene. Përveq kristalinitetit të lartë në reshpet kristalore kemi edhe serinë rrudhosëse, strukturat thyerëse. Vijëzimi i strukturës tektonike të pellgut është ndërtuar nga tri dislokacione kryesore. Dislokacioni i parë përfshinë ultësirën e lumit të Krivarekës në drejtim VP- JL, kurse i dyti lumin e Hogoshtit në drejtim VJ. Linja e tretë dislokative shtrihet prej Karaqevës së Epërme kah rreshet kristalore deri në grykën e lumit të Hogoshtit në drejtim VL- JP (fig.2.). Përveç këtyre linjave kryesore dislokative janë të njohura edhe shkarjet të tjera të cilat sipas gjatësisë janë të vogla. Në përroin Karabat (Karaqevë e Poshtme) janë vërtetuar dy shkarje në largësi prej 70 m, të cilët ndërprejnë ranorët në këtë pjesë. Pellgu Terciar i Krivarekës përveç shkarjeve dhe rrudhosjeve posedon edhe disa forma antiklinale dhe sinklinale. Shtrirja gjenerale e krahëve të shtresave është e orientuar në drejtim JJP. Përveç këtyre hulumtimeve përgjatë shtratit të lumit të Hogoshtit dhe Krivarekës sedimentet Terciare janë të rrudhosura. Si pasojë e këtyre faktorëve janë formuar dy sinklinale njëra sinklinale në JL të Bllatës –Trojës, kurse në VP sinklinalja Berivojcë – Koretin –Devojačka Çuka të cilët janë të ndara me antiklinalen e Koretinit – Jurishtes. Ndërmjet këtyre antiklinaleve dhe sinklinaleve të Devojačka Çukës, është vërtetuar shkarja. Gjithashtu në mes të Hodonocit dhe Domarocit gjendet një sinklinale e ndërtuar nga mergelet krahët e së cilës në kontaktin tektonik janë me rreshet kristalore. Me shkarjen e lumit të Hogoshtit është e ndarë kjo sinklinale nga sinklinalja e Bllato - Trojës.

Depresioni i Moravës është regjion tektonik i ulur i cili është i mbushur me sedimente shtresore dhe transgresive të miocenit, sedimente liqenore me qymyr të kohës së pliocenit. Pellgu i Moravës është zhytur për gjatë shkarjeve anësore në fillim të miocenit.



ANALIZA HAPESINORE

Karakteristikat themelore

Komuna e Kamenicës kryesisht ka qenë njohur për nga industria e materialit ndërtimor, pllakave te qeramikës dhe sintermagnezitit. Mirëpo eksitojnë edhe kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, zejtarisë, tregtisë etj.

Karakteristikat kryesore të komunës janë:


- Një sipërfaqe prej 523 km²;
- Terren kodrinoro-malor (60%), dhe të rrafshëta (40%)
- Përshkohet nga lumenjtë: Krivareka, Lumi Hogosht dhe Morava e Binçës
- Sipërfaqe te mjaftueshme për zhvillimin e bujqësisë me rreth 29 304 ha me kullosa dhe livadhe 12.543ha
- Lidhje e mirë rrugore me magjistralen Gjilan - Bujanoc;
- Numri i banorëve në komunën e Kamenicës vlerësohet të jetë 57000 banorë.
- Në qytet jetojnë rreth 10.200 banorë
- Në fshatra jetojnë rreth 46.800 banorë
- Dendësia mesatare e popullsisë është 109 ban/km²
- Rritja mesatare vjetore e popullsisë në këtë komunë është 0.29%.
- Ekziston dallim i vogël në strukturën gjinore (51 % meshkuj dhe 49% femra)
- Etnitetet që jetojnë në këtë komunë janë: shqiptarë 82.5, serb 16.6%, romë 0.8% (Vlerësim OSBE)
- Vlerësohet se në komunën e Kamenicës, nga pjesa e popullsisë aktive 60-65% (mosha 16-65 vjeç)



ANALIZA HAPESINORE

I. Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme

Shkalla e lartë e papunësisë në Kosovë konsiderohet si njëra nga çështjet kyçe, që reflektohet me probleme të shumta në shoqërinë kosovare. Veçorit demografike në Kosovë determinojnë përbërjen e kontingjentit të punës, siç janë popullsia shumë e re dhe emigracioni. Vlerësohet se rreth 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërsa rreth 60 % e popullsisë janë në moshë pune. Shkalla e papunësisë në Kosovë është më e lartë në rajon. Popullsia shumë e re bën që çdo vit të rritet kontingjenti i punës. Papunësia më e lartë është te personat në moshë të re (16 – 24 vjeç), kjo moshë përfshin rreth 40 % të numrit total të papunëve. Norma e papunësisë paraqitet tepër e lartë për femra, pavarësisht nga norma shumë



e lartë e jo-aktivitetit për to. Problem tjetër i papunësisë në Kosovë është edhe papunësia afatgjate, që vlerësohet se rreth 80 % e të papunëve janë të papunë afatgjatë (të papunë për më shumë se 12 muaj).

Shkalla e papunësisë në komunën e Kamenicës vlerësohet ndër më të lartat në Kosovë. Të dhënat e marra nga Zyra e Punës dhe Punësimit në komunën e Kamenicës tregojnë të pa punët apo punëkërkuessit e regjistruar në këtë zyre nga vendbanimet e ndryshme të Kamenicës e që ky numër është shumëfish më i vogël në krahasim me numrin real të papunëve, sepse pjesa dërmuese e të pa punëve nuk janë të paraqitur apo evidentuar, po-ashtu nuk ka qenë i evidentuar edhe numri i popullsisë aktive sipas vendbanimeve, prandaj është vlerësuar përqindja e punëkërkuessve në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë për secilin vendbanim. Megjithatë, përmes këtyre të dhënave ne do të mund të paraqesim gjendjen afërsisht reale, duke e krahasuar gjendjen e papunësisë në mes të vendbanimeve (hapësirave) të ndryshme brenda vet komunës së Kamenicës.

Vendbanimet të cilat kanë shkallë më të lartë të papunësisë, dhe janë shumë mbi mesataren e komunës janë: Meshina, Ranilluku, Dazhinca, Bushinca, Bosca dhe Shipashnica e poshtme. Papunësia më të ulët (dukshem) nën mesataren e komunës kanë vendbanimet: Zajçefci, Vriçefc, Terstena, Strezofci, Sedllari, Leshtari, Laçiçi, Lisoca, Kremenata, Gragjeniku, Karaçeva e epërme, Feriçeva, Karaçeva e ulët, Domoroci, Gjyrisheci.

Faktorët të cilët kanë ndikim të madh në shkallën e lartë të papunësisë në këto hapësira janë të ndryshëm, por ndikim më të madh ka zhvillimi i ulët ekonomik. Rrethanat e tilla të moszhvillimit kanë ndikuar edhe në migrimin e një numri të konsiderueshëm të banoreve të kësaj komune nga vendlindja e tyre. Migrimi i popullsisë në këtë komunë kryesisht lidhet me faktorin ekonomik dhe gjetjen e mundësive për punësim në viset tjera të Kosovës dhe në botën e jashtme. Kuadrot po ashtu, për shkak të pamundësisë për punësim janë duke u shpërngulur vazhdimisht.

Pozita periferike e komunës dhe largësia nga qendrat tjera të zhvilluara e rrit problemin e punësimit. Vendbanimet që kanë shkallë më të lartë të papunësisë kryesisht shtrihen në pjesët më periferike të komunës dhe po ashtu në terrenet kodrinoro – malore. Pjesa më e madhe e këtyre vendbanimeve për shkak të pozitës izoluese në një anë dhe me nivele më të ulëta të zhvillimit të infrastrukturës dhe shërbimeve në përgjithësi, kanë ndikuar në shkallën më të lartë të papunësisë në këto vendbanime.


Vendbanimet që shtrihen në pjesët më të ulëta dhe më afër qendrës komunale kanë gjendje më të mirë, për faktin se janë edhe më afër shërbimeve dhe me gjendje më të mirë të infrastrukturës teknike. Megjithatë, edhe në këto hapësira nuk kemi ndonjë dallim të theksuar për faktin se vetë qyteti i Kamenicës nuk është ndonjë qendër e madhe e cila mund të konsiderohet si një potencial ekonomik i kësaj komune për të ndikuar edhe në zvogëlimin e papunësisë.

Hapja e mikro-ndërmarrjeve dhe NVM-ve, sidomos pas luftës ka pasur prioritet dhe ato janë burimi kryesor i gjenerimit të ardhurave dhe punësimit, por kjo nuk mjafton. Këto ndërmarrje nuk sigurojnë vende të reja të punës në të ardhmen, andaj duhet përcaktuar strategjinë e zhvillimit afatgjatë të Komunës.

Komuna e Kamenicës karakterizohet me pasuri të konsiderueshme minerale të jo-metaleve. Bazuar në këto resurse natyrore, në të kaluarën janë ngritur edhe kapacitetet prodhuese të tyre. Me këtë rast duhet përmendur fabrikën për prodhimin e pllakave të qeramikës XIQ “Karaçeva”, fabrikën për prodhimin e sintermagnezitet XIM “Strezoci” si dhe fabrikën e tjegullave në Kamenicë. Këto ishin bartëse të zhvillimit ekonomik të komunës, në periudhën e para luftës. Para luftës ka qenë ekskluzivisht i zhvilluar sektori shoqërorë në ekonomi. Në komunë kanë ekzistuar tetëmbëdhjetë (18) ndërmarrje shoqërore dhe publike. Pas luftës (së vitit 1999) gjendja në ekonominë shoqërore/ publike të komunës ishte e mjerueshme. Ajo plotësisht ishte (edhe tani në masë të madhe është) jashtë funksionit. Pas vitit 2000 me pronën shoqërore të komunës menaxhon AKM-ja. Sipas Rregullores së UNMIK-ut Nr 2002/12 e plotësuar me Rregulloren 2005/18 AKM, si aktivitet të saj primar ka privatizimin, likuidimin e

ANALIZA HAPESINORE

ndërmarrjeve shoqërore si dhe ristrukturimin (konsolidimin/ korporatizimin) e atyre publike. Kamenica ka një relief dhe kushte klimatike të përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Për zhvillimin e kësaj dege të rëndësishme të ekonomisë, rol me rëndësi kanë luajtur kooperativat bujqësore, përmes të cilave realizohej prodhimi, tregtimi, këshillimi dhe furnizimi me agro-inpute. Orientimi drejt një zhvillimi më të mirë të kësaj veprimtarie, duke ofruar kushte më të përshtatshme do të jetë një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të komunës dhe kështu do të reflektoj edhe në uljen e shkallës së papunësisë.



ANALIZA HAPESINORE

Rekomandimet


- Mbjtja e evidencave të përhershme dhe të vazhdueshme statistikore mbi trandet e punësimit dhe papunësisë në nivelin komunal.
- Vlerësimi i politikave ekzistuese ekonomike se në çfarë mase janë në harmomi me uljen e papunësisë
- Ndër prioritetet e para të politikave zhvillimore komunale duhet të krijojnë kushte për krijimin e vendeve të reja të punës
- Trajnimet profesionale në lëmi të ndryshme për grupe të caktuara të shoqërisë sipas kërkesave të tregut.
- Potenciali ekonomik që konsiderohet sektori privat duhet të përkrahet vazhdimisht për zgjerimin e aktiviteteve të tyre, e cila paraqet një bazë të mirë për rritjen e punësimit.
- Bazë shumë me rëndësi për rimëkëmbjen ekonomike të komunës është funksionimi efikas i fabrikave ekzistuese, si dhe investimet drejt një bujqësie intensive.



ANALIZA HAPËSINORE

2. Varfëria e lartë dhe në rritje të vazhdueshme

Hulumtimet e kohëve të fundit tregojnë se varfëria në Kosovë është gjerësisht e përhapur - më tepër se gjysma e popullatës (50.3 %) jeton në varfëri, kurse 16 % e popullatës jeton në varfëri ekstreme¹. Shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik, procesi i ngadalshëm i privatizimit, shkalla e lartë e papunësisë, sidomos te të rinjtë, janë faktorë kryesorë të shkallës së lartë të varfërisë². Fakti se shkalla e varfërisë në Kosovë është më e larta në rajon, mund të thuhet se çështje kyçe në shoqërinë kosovare është varfëria.



Varfëria është një fenomen kompleks social gjerësia e së cilës është vështirë të matet me mjete standarde. Kërkohen të dhëna të ndryshme si: Standardi jetësor, të ardhurat për kokë banori, kushtet e banimit, zgjatja mesatare e jetës, gjendja në edukimin elementar, qasja në shërbimet publike etj. Në mungesë të dhënave si pasojë e mungesës së regjistrimit të popullsisë janë marrë për bazë numri i familjeve dhe banorëve me asistencë sociale të cilat nuk mund të na japin një

¹ Banka Botrore, Maj 2004

² UNDP, Raporti i Zhvillimit Njerëzor, Kosova 2002
Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Institut për Planifikim Hapësinor
Komuna e Kamenicës

ANALIZA HAPESINORE

shtrirje precize të problemit, por në bazë të këtyre rezultateve mund të ndahen zonat ku ky problem është më shumë i shprehur dhe zonat me shprehje më të vogël të këtij problemi.


Të dhënat për numrin e banorëve me asistencë sociale sipas vendbanimeve janë marrë nga Qendra Sociale në komunën e Kamenicës dhe kjo pjesë e popullsisë konsiderohet të jetë me varfëri të theksuar, por shkalla e varfërisë është më e madhe kur vlerësohen edhe parametra tjerë të varfërisë.

Pas vlerësimit dhe analizës së të dhënave, vërehet se shkallë më të lartë të varfërisë në komunën e Kamenicës kanë fshatrat: Dazhincë, Meshinë, Velegllavë, Bllatë dhe Shahiq.

Mesatarja e përqindjes së banorëve që janë nën asistencë sociale (banorë të varfër) për komunën e Kamenicës është llogaritur të jetë 13.6 %, dhe kjo përqindje mund të konsiderohet si varfëri ekstreme. Në zbutjen e këtij problemi në komunë ka ndikuar dukshëm kurbeti si një fenomen i theksuar, ku ndihma e mërgimtarëve për të afërmit ka qenë e vazhdueshme.

Një numër i konsiderueshëm i vendbanimeve nuk janë të paraqitura në grafikën për faktin se për ato vendbanime nuk janë dhënë shënime për asistencën sociale nga institucioni përkatës. Këto vendbanime në hartë janë paraqitur, por me ngjyrë të bardhë dhe nuk janë klasifikuar në hartën e varfërisë se në cilën shkallë të varfërisë bëjnë pjesë.

Në përgjithësi shkallën e lartë të varfërisë në këtë komunë e ka kushtëzuar një varg faktorësh: Shkalla e ulët e zhvillimit ekonomik, larg qendrave të zhvilluara urbane, shkalla shumë e lartë e papunësisë, niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore dhe arsimore etj.





Rekomandimet

- Është shumë e rëndësishme që niveli i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore të përmirësohet (Kuadri arsimor dhe shëndetësor, hapësira, pajisjet, zvogëlimi i distancave nga objektet në shtëpi etj.). Kjo do të ndikonte drejtpërdrejtë në përmirësimin e kualitetit të jetës në përgjithësi si dhe ngritjen e standardit jetësor.
- Në aspektin e edukimit dhe shëndetësisë, kujdes i veçantë duhet ti kushtohet grupeve të caktuara shoqërore që paraqiten me kërkesa të veçanta dhe mjaftë specifike.
- Përmirësimi i shërbimeve publike në këto hapësira do të ndikoj shumë në uljen e shkallës së varfërisë: rrugët, kanalizimi, ujësjellësi, telekomunikimet etj.
- Të planifikohet një perspektivë më e mirë për zhvillimin dhe përkrahjen e industrisë ekzistuese si dhe bujqësisë që do të ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm të kësaj komune.

3. Depopullimi i vendbanimeve

Depopullimi si dukuri shfaqet nga ndikimi i disa faktorëve: Kushteve natyrore, zhvillimit ekonomik, faktorëve social, nivelit të shërbimeve etj. Depopullimi i vendbanimeve në Kosovë shfaqet me pasoja të llojllojshme për vendbanimet që depopullohen dhe për vendbanimet ku imigron popullsia. Pasojat për vendbanimet ku ndodh depopullimi janë: Lënia e tokës pa punuar (ose punimi ekstensiv), largimi i fuqisë së re punëtore, largimi i personave të shkolluar, zvogëlimi i martesave dhe lindjeve, paraqitja e dukurive deviate tek fëmijët dhe të rriturit etj. Në qytete ku kryesisht vendoset popullsia gjithashtu paraqiten pasoja negative si: Rritja e çmimit të banesave, zgjerimi pa plan dhe pa kontroll i qyteteve, rritja e numrit të popullsisë dhe mungesa e infrastrukturës së nevojshme, mungesa e shërbimeve etj.



Në komunën e Kamenicës ekzistojnë vendbanime ku shkalla e depopullimit është shumë e lartë, si pasojë e kushteve të lartpërmendura. Harta paraqet gjendjen e depopullimit në këtë komunë. Analiza e të dhënave për shkallën e depopullimit është bërë përmes metodës komperative, sipas të cilës është vlerësuar numri i banorëve sipas vendbanimeve në vitin 1981 dhe 2005, dhe konstatimi se kemi pasur rritje apo zvogëlim të popullsisë për këtë periudhë kohore (24 vjeçare), duke marrë parasysh edhe shtimin e popullsisë.

ANALIZA HAPESINORE

Vendbanimet si: Bllata, Bolefci, Bratillofci, Bushinca, Qarrakofci, Dazhinca, Gillogoci, Karaçeva, Grizima, Kostadini, Meshina, Moçari, Hodefci, Terstena dhe Zhuja kanë shkallën më të lartë të depopullimit. Popullsia në këto fshatra është shpërngulur në mënyrë masive, ku për një periudhë kohore 24 vjeçare është zvogëluar aq shumë sa që në disa prej tyre nuk kanë mbetur fare banorë apo kanë mbetur shumë pak. Drejtimet e migrimit të popullsisë janë të brendshme dhe të jashtme. Një numër i kësaj popullate ka imigruar në qendrën lokale të kësaj komune (Kamenicë) por një numër i konsiderueshëm ka emigruar në qytetet tjera të Kosovës sidomos në Gjilan dhe Prishtinë. Migrimet e jashtme po ashtu janë mjaft të shumta dhe popullata nga vitet 1981 ka emigruar në një masë të konsiderueshme edhe jashtë vendit.

Faktorët kryesor që kanë ndikuar në shkallën e lartë të depopullimit në këto vendbanime janë: Shkalla e lartë e papunësisë, varfëria, mungesa e shërbimeve, zhvillimi i pabarabartë ekonomik, niveli më i ulët i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore etj.

Rekomandimet

Për zvogëlimin e shkallës së depopullimit rekomandohet që të stimulohet popullsia e këtyre vendbanimeve për veprimin dhe krijimin e kushteve më të mira për jetesë në këto hapësira. Që të arrihet ky rezultat është e nevojshme të hapen mundësi për zgjerimin e aktiviteteve ekonomike dhe investime në mjete teknike, lehtësime në shkollimin e të rinjve, përmirësimin e shërbimeve (rrugët, ujësjellësi, kanalizimi, energjia etj.), mbrojtja dhe menaxhimi më i mirë i resurseve natyrore etj.

ANALIZA HAPËSINORE

4. Shërbimet e ulëta arsimore dhe shëndetësore


Arsimi

Sistemi i edukimit në komunën e Kamenicës është i organizuar në tri nivele: edukimi parashkollor, fillor dhe i mesëm. Në analizë është trajtuar vetëm arsimi fillor edhe atë shkollat fillore të plota si dhe arsimi i mesëm.

Në komunën e Kamenicës funksionojnë 17 shkolla fillore të plota dhe katër shkolla të mesme si dhe 8 shkolla fillore të plota serbe dhe katër të mesme. Paraqitja sa më reale e nivelit të shërbimeve arsimore në komunën e Kamenicës është realizuar përmes analizës së indikatorëve si:

- sipërfaqja shkollore/nr. nxënësve
- gjendja fizike e objekteve
- kuadri arsimor/nr. nxënësve
- kuadri përkatës – kualifikimi i mësimitdhënësve
- largësia e objekteve shkollore

Në hartë është i paraqitur vetëm niveli i shërbimeve në shkollat fillore shqiptare, ndërsa në grafikun e mëposhtëm paraqiten edhe mungesat e shërbimeve në shkollat e mesme shqiptare.




ANALIZA HAPËSINORE

Shërbimet serbe në hartë janë paraqitur vetëm si shtrirje hapësinore, ndërsa sa i përket nivelit të tyre ai nuk është paraqitur në hartë sepse ai është mjaft i kënaqshëm.

Niveli i ulët i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Kamenicës.

Niveli mesatar i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Rogoçicës, Tugjecit, Busavatës dhe në shkollën fillore të Krilevës.

Niveli i lartë i shërbimeve arsimore vërehet në shkollën fillore të Koretinit, Hogoshtit, Kopernicës, Lisockës, Desivojcës, Poliçkës, Topanicës, Shipashnicës, Kraqevës së Epërme, Kraqevës së Poshtme, Hodonovcit, si dhe në shkollën fillore të Strezovcit.



Rekomandimet

Mungesa e hapësirës shkollore është sidomos e shprehur në shkollën e mesme teknike të Kamenicës, pastaj në shkollën e mesme të Kamenicës, shkollën fillore të Kamenicës e më pastaj në shkollën fillore të Shipashnicës. Mu për këtë arsye rekomandohet zgjerimi apo ndërtimi i objekteve të reja shkollore në këto vendbanime.

Gjendja e dobët fizike e objekteve sidomos vërehet në shkollën fillore të Busavatës, pastaj në shkollën fillore të Kamenicës, Rogoçicës, Koretinit, Hogoshtit, Tugjecit, Topanicës, Karaqevës, Krilevës, pastaj në shkollën e mesme të Kamenicës, shkollën e mesme teknike të Kamenicës, shkollën e mesme teknike të Rogoçicës si dhe në shkollën e mesme të Hogoshtit. Shkollat kanë nevojë për investime në objekte, kanalizim, ujësjellës në rregullim të oborreve dhe të fushave sportive dhe pajisje me laboratorë, kabinete dhe punëtori me mjete të nevojshme konkretizuese arsimore.

Kuadri i mjaftueshëm, pra raporti nxënës – mësimdhënës plotëson kushtin 22nx./1 mësimdhënës i përcaktuar nga MASHT (Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë).

Mungesa e kuadrit përkatës respektivisht kualifikimit të mësimdhënësve sidomos vërehet në shkollën fillore të Tugjecit dhe Krilevës, pastaj në shkollën fillore të Desivojcës, Poliçkës, si dhe në shkollën e mesme të Kamenicës, shkollën e mesme teknike të Kamenicës, shkollën e mesme të Rogoçicës dhe në shkollën e mesme të Hogoshtit. Në këtë kuptim duhet ndihmuar më tej zhvillimin profesional të punëtorëve shkencorë të rinj dhe të atyre ekzistues.


Nxënësit e komunës së Kamenicës kalojnë distanca të gjata deri në shkollë. Sidomos nxënësit e vendbanimeve që gravitojnë në shkollat e mesme të Kamenicës duhet të rrugëtojnë gjatë deri në shkollë. Gjithashtu edhe nxënësit e vendbanimeve që gravitojnë në shkollën fillore të Kamenicës, Rogoçicës, Lisockës si dhe nxënësit e shkollës fillore të Desivojcës, Poliçkës, Strezovcit, kalojnë distanca të gjata të rrugës deri në shkollë. Rekomandohet që në këto vendbanime të lehtësohet mundësia e qasjes në shërbimet arsimore duke organizuar transport për nxënës.

ANALIZA HAPËSINORE

Shëndetësia

Bartëse kryesore e kujdesit primar shëndetësor në komunën e Kamenicës është Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare e cila ofron shërbime shëndetësore 24 orë, tri Qendra të Mjekësisë Familjare të vendosura në viset rurale, dy në lokalitetet shqiptare dhe një në lokalitetet serb, si dhe njëzet Ambulanca Shëndetësore (13 në lokalitetet shqiptare dhe 7 në lokalitetet serbe). Paraqitja sa më reale e nivelit të shërbimeve shëndetësore në komunën e Kamenicës është realizuar përmes analizës së indikatorëve si:

- o objekti shëndetësor/nr. banorëve
- o gjendja fizike e objekteve
- o kuadri shëndetësor/nr. banorëve
- o kuadri përkatës – kualifikimi i personelit mjekësor
- o largësia e shërbimeve shëndetësore




ANALIZA HAPESINORE

Niveli i ulët i shërbimeve shëndetësore sidomos vërehet në ambulancën e Lisockës, Strezovcit, Krilevës, Hajnovcit, pastaj në ambulancën e Desivojcës, Tugjecit, Busavatës, Bosces, Domorovcit, Kololeqit, Bozhevcit, Rajanovcit si dhe në ambulancën e Bushincës.

Niveli mesatar i shërbimeve shëndetësore vërehet në ambulancën e Topanicës, Karaqevës si dhe në ambulancën e Shipashnicës së Epërme.

Niveli i lartë i shërbimeve shëndetësore vërehet në QKMF-në e Kamenicës, QMF-në e Rogoçicës, QMF – në e Hogoshtit, QMF- në e Ranillugut si dhe në ambulancën e Koretinit, Muçivërcës dhe Ropotovës.

► Graf. - Niveli i shërbimeve shëndetësore



Rekomandimet

Objekti shëndetësor në raport me numrin e banorëve plotëson kushtin 1 Ambulantë/6000 banorë, 1 QMF/10.000 banorë, 1 QKMF/ 100.000 banorë që do të thotë se komuna e Kamenica mbulohet sa i përket objekteve shëndetësore.

Gjendja e dobët fizike e objektit vërehet sidomos në ambulancën e Muçivërcit, ambulancën e Lisockës dhe ambulancën e Krilevës, pastaj në ambulancën e Strezovcit, ambulancën e Busavatës, si dhe në QKMF-në e Kamenicës, QMF- në e Rogoçicës, QMF-në e Hogoshtit si dhe në ambulancën e Domorovcit. Sistemi shëndetësorë në komunën e Kamenicës ka nevojë për investime të mëtejshme si në objekte, infrastrukturë ashtu edhe në mjete të punës.

Kuadri i mjaftueshëm në raport me numrin e banorëve nuk e plotëson kushtin 1 mjek + 2 motra/2000 banorë i përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë. Mungesa e kuadrit vërehet sidomos në ambulancën e Bozhevcit, Rajanovcit, Bushincës, pastaj në ambulancën e Topanicës, Karaqevës, Shipashnicës, Desivojcës, Kopërnicës, Lisockës, Tugjecit, Strezovcit, Krilevës, Busavatës, Hajnovcit, Bosces, Domorovcit dhe ambulancës së Kolloleqit. Po ashtu vërehet qartë se kuadri aktual shëndetësor është i pa specializuar. Lidhur me këtë duhet punuar në zhvillimin e kapaciteteve të reja superiore si dhe në aftësimin e atyre ekzistuese.

Popullata e vendbanimeve që graviton sidomos në QKMF-në e Kamenicës, QMF-në e Rogoçicës, QMF-në e Ranillugës, ambulancën e Hajnovcit si dhe banorët që gravitojnë në ambulancën e Desivojcës, Tugjecit, Strezovcit, Ropotovës, Bosces dhe në ambulancën e Bozhevcit duhet të rrugëtojnë gjatë deri te këto shërbime shëndetësore. Rekomandohet që në këto vendbanime të lehtësohet mundësia e qasjes në shërbimet shëndetësore duke organizuar transport për popullatën.

5. Degradimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore

Trashëgimia kulturore

Vendbanimet e Kosovës ekzistojnë që nga kohërat e hershme. Shumë vendbanime gjatë historisë janë shkatërruar nga luftërat në periudha të ndryshme kohore ku si pasojë e tyre ishte shkatërrimi i banimit e po ashtu edhe objekteve tjera përcjellëse si: kalatë, kishat, xhamitë, tyrbet etj. që e përbëjnë të kaluarën apo trashëgiminë kulturore të një treve.

Vendbanimet në komunën e Kamenicës datojnë nga kohërat e hershme, falë kushteve natyrore të begatshme (male me pyje të dendura, kullosa dhe fusha pjellore, vend i pasur me florë, faunë si dhe xehe të shumta – ari, argjendi, plumbi, hekuri etj.), klimë e përshtatshme kontinentale e gërshtuar me at mesdhetare si dhe pozitë e përshtatshme gjeografike dhe gjeostrategjike.

Dëshmitë e ekzistimit të vendbanimeve të hershme janë:

- Shumë kështjella
- Gjytete
- Kisha
- Manastire

Gjetjet arkeologjike

1. Lokaliteti arkeologjik Gjyteti në Gjyrishec
2. Lokaliteti arkeologjik në Kranidell
3. Lokaliteti arkeologjik në Topanicë
4. Lokaliteti arkeologjik në Strezoc
5. Lokaliteti arkeologjik në Busavatë

Kalatë

1. Kalaja e Kamenicës (Kamenicës)
2. Kalaja e Kopernicës – periudha romake
3. Kalaja e Kranidellit – periudha romake

Objektet e kultit të krishterë

1. Manastiri në Moçar - Periudha: Romakemb.
2. Kisha në Vaganesh mb.
3. Kisha e vjetër romake dhe kisha e re ortodokse – Hajnocmb.
4. Kisha në Kamenicë (Dardanë)
5. Kisha në Domoroc

Objektet e kultit islam

1. Xhamia e Zajçecit
2. Xhamia Hodonocit
3. Xhamia e Kopernicës
4. Xhamia në Kamenicë (Dardanë)
5. Xhamia e Desivojcës
6. Xhamia e Zhujës
7. Teqja e Topanicës mb.

ANALIZA HAPESINORE

8. Tyrbja e Dazhnicës

Objektet e banimit- Shtëpitë

1. Shtëpi në qytet Komuna pas vitit 1945
2. Shtëpia e Sylë Haskut Krematatë
3. Shtëpia ku qëndroi Mulla Idriz Gjilani, për disa vite - Ilegalisht
4. Shtëpia e hoxhës Mahmutit – Srezoc
5. Shtëpi banimi – Moçar, periudha :Shek:XIX, Mjeshtri Popullor, Pronë private
6. Shtëpi e vjetër në Kormjan
7. Shtëpi banimi e Demush Feriz Hajdarit - Zhujë
8. Shtëpi banimi në Dazhnicë
9. Shtëpi e vjetër në Topanicë
10. Objekte banimi në Vryçec

Objektet Shoqërore

1. Përmendore e Luftës së Dytë Botërore
2. Përmendore – Kopernicë

Çezmat- Karakteristikë identifikuese për Qytetin

Objektet bujqësore


1. Plevicë (Pleme) e Shillovëve të Srezocit
2. Mulli binjak - Hogosht
3. Mulli në Shipashnicë
4. Kosh në Koretin
5. Kosh në Kormjan

Trashëgimia e Luajtshme

1. Shpata (v 1210 sipas Hixhrit)
2. Maje heshte, shek II p. e. s. Konçul
3. Kultura krishtere Poliçkë


Numizmatikë (tërësi e monedhave të një periudhe historike)

1. NUMIZMATIKË Filipi I (244 – 249), monedha
2. Maksimianus (286 – 305), monedha
3. Gardianus III (238 – 244), monedha
4. Teodosius (379 – 395), monedha



ANALIZA HAPESINORE

Monumente kulturore në komunën e Kamenicës



Nga vizita në terren e bërë më datën 06.06.07 janë marrë këto opinione:

- Në monumentet e vizituara, vërehet që nuk ka kurrfarë kontrolli dhe kujdesi institucional;
 - Infrastruktura rrugore nuk është në gjendje të mirë në të gjitha monumentet kulturore dhe historike;
 - Mungon shenjzimi i këtyre monumenteve;
- I. Manastiri Burg, shek XIV. - Hajnovc

ANALIZA HAPESINORE

Manastiri ishte në gjendje të mirë, nuk kishte dëmtime dhe dukej se ishte i përdorshëm;



2. Manastiri Rgjavc, shek.XIV. – Moçarë – Gërmadhat e këtij manastiri ishin dhe ky monument nuk kishte kurfarë rrethoje dhe nuk po mbrohej nga askush;



3. Teqja e Sheh Zenel Abedinit, shek.XVIII. – Topanicë – Monument i lënur tërësisht pas dore. Nuk është i mbikqyrur nga askush. Nëse vazhdohet në këtë mënyrë, kjo teqe do të dëmtohet edhe më tepër.



Disa përshkrime të shkurta për VB e komunës së Kamenicës, lidhur me të kaluarën pra trashëgiminë e tyre.

Bozhefci - Është VB mjaft i vjetër, ndoshta VB iliro-dardan. Ekzistojnë gërmadha të gjytetit në vendin "Guri i Hoxhës". Dedicimi I kështjellës ishte që të mbron VB dhe shkritoren.

Busovata - Në këtë fshat ka kaluar rruga e vjetër që ka lidhur Novo Bërdën, Kamenicën, Bujanocin e Vranjën. Ka kaluar rruga Kamenicë, Busovatë, Përlepnicë, Gjilan. Në bazë të disa materialeve arkeologjike të gjetura në një shpellë dëshmohet se ky fshat daton që nga koha e

ANALIZA HAPESINORE

paleolitit. Ekziston kalaja e cila daton që nga shekulli II, themelet e një kishe dhe një shpellë, varre etj.

Cvirca - VB me gurë miniere, popullata e quan “Rudniku i Ilirëve”.

Kamenica - Në një kodër të qytetit, afër së cilës kalon lumi, gjendet Kështjella (Kulina ose Gradisha), tani gjenden muret e një qyteti të shkatërruar. Janë gjetur në afërsi të saj Stella (pllaka guri mbivarrore) të shek. II.

Dermaku - VB i vjetër iliro-shqiptar, në të cilin ekzistojnë varret e vjetra dhe themelet e kishës.

Desivojca - Në lokalitetin e këtij fshati që nga koha e romakëve thuhet se është eksploatuar xehja e plumbit, zinkut etj. Pra ka ekzistuar xeherorja në atë kohë. E ndërtuar gjatë sundimit romak, ka ekzistuar kisha e Hajdukut e kohës iliro-arbëreshe.

Domoroci - Lokalitet i vjetër ilire-dardan. Ky lokalitet ka qenë i banuar qysh nga koha e eneolitit ku janë gjetur gërmadhat e një kështjelle.

Drenoci - Gjurmë të një kishe katolike shqiptare. Thonë se ekzistojnë edhe tumat ilire në këto anë.

Firaja (Firiqeva) - VB i vjetër, ku dëshmohet me një kishë të vjetër e quajtur kisha Thyme e periudhës së sundimit Romak (kishë ilire).

Gardheshi (Gragjeniku) - VB i vjetër në të cilin jetonte popullata ilire-dardane, e cila qysh heret e kishte pranuar krishterimin, kjo dëshmohet edhe në gjurmët e kishës, e cila në popull njihet si kisha e Rimit. Në kohën e mesjetës në këto anë është bërë shkrirja e metaleve (në popull quhet Samakovë). Në këtë kishë në mënyrë tradicionale çdo vjet më datën 5Maj mbahen gara sportive (me kuaj, gjuajtje të gurit, mundje etj.), saktësisht nuk dihet prej kur daton kjo traditë.

Gmica - Në bazë të toponimeve “Mali i kishës”, “Kroni Maks”, dëshmon së ekzistuari kisha të vjetra shqiptare.

Grizima - Në këtë fshat gjenden muret e manastirit mesjetar, që edhe sot janë të ruajtura.

Gugolloci - Ekziston një kishë e vjetër.

Gurabardhi (Strezoci) - Është VB i grupit kulturor dardan (shek.VII–IV-p.e.s) të tipit kodrinor i vendosur në një kodrinë. Mbi Strezoc gjendet një “Fortesë” parahistorike në të cilën përpos materialit të periudhës romake, ka material edhe të periudhës së hershme romake.

Hajnoci - Ekziston kalaja ilire që në popull quhet Kulina, kisha e quajtur kisha e Rimit. Është gjetur një bazilikë disangjyrëshe bizantine. Sot kjo kishë është e përvetësuar nga serbët.

Hodanoci - Në këtë V.b. gjendet kishë iliro-romake, ku edhe sot gjenden themelet e saj.

Kopra (Kopërnica) - Një ndër fshatrat më të lashta të kësaj ane, me Kala e cila gjendet në veri të fshatit, ku edhe sot kanë mbetur gjurmët e vijave të mureve që flasin jo vetëm për kala por për Gjytet.


Koretini - Lokalitet i vjetër. Dëshmohet me gjetjet e ndryshme dhe me një kishë shqiptare, të cilën serbët në themelet e saj ndërtuan kishën e tyre. Pra, kjo dëshmon se ishte lokalitet i vjetër iliro-dardan.

Krileva – V.B. i vjetër iliro-dardan, e cila ka pasur kalanë e quajtur “Kulla” e cila ishte e lidhur me kalanë e Novo Bërdës, me shkritore të xehes dhe gjurmë të një kishe.

Vaganesh – V.B. i vjetër, ndoshta ilirë i periudhës antike të vonë, mesjetës së hershme e përvetësuar nga serbët.

Nga kjo pasqyrë e vështrimit historik të kësaj ane, na jep të konkludojmë se përkundër sfidave të ndryshme që e kapluan këtë territor si luftërat, dyndjet e detyrueshme të banorëve, sëmundjet, vërshimet, tërmetet etj., populli shqiptar arriti ta mbaj dhe ruaj identitetin e tij kombëtar në këto hapësira.

ANALIZA HAPESINORE



Në mungesë të listës së monumenteve kulturore të viteve të mëparshme dhe të atyre të sotme, nuk kemi qenë në gjendje të bëjmë analizat lidhur me çështjen e cila po e mundon tërë Kosovën e po ashtu edhe komunën e Kamenicës, pra Sa dhe ku është i shprehur degradimi i trashëgimisë kulturore.

Rekomandimet

Që të kemi një harmonizim të plotë lidhur me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, është i domosdoshëm bashkëpunimi i drejtorive komunale për kulturë me Institutet për mbrojtjen e monumenteve kulturore, MKRS-Departamentin e kulturës/ dhe me MMPH-Institutin për planifikim hapësinor. Ky bashkëpunim do të mund të rezultojë me një gjendje reale të pasurive të shumta të monumenteve kulturore-historike që ka Kosova në tërësi dhe Komunat në veçanti, i cili do të ketë si rezultat mbrojtjen, ruajtjen, konservimin, zhvillimin dhe promovimin e saj;

Respektimin e legjislacionit (ligjit për planifikim hapësinor, ligjit për trashëgimi kulturore), të cilët do të mundësojnë zhvillim të qëndrueshëm të komunave në sferën e trashëgimisë kulturore dhe historike;

Niveli komunal duhet që të ngrit vetëdijen e popullatës vendase për rëndësinë e trashëgimisë kulturore;

Të bëhet shenjëzimi i monumenteve që kanë status të mbrojtjes dhe monumenteve tjera të rëndësishme për komunën (të vihen shenjat e identifikimit të monumentit, në afërsi të tyre), do të jetë ndihmesë për turistët që e vizitojnë këtë rajon;

Katalogu i komunës është shumë i rëndësishëm sepse përmes tij me pak fjalë dhe fotografi do të promovohen pasuritë dhe potencialet e komunës së Kamenicës, i cili do të ndikojë në zhvillimin e të gjitha sferave pra, një zhvillim të gjithmbarshëm të saj.

Drejtoria për kulturë e K.K. Kamenicë duhet që sa më parë të hartojë listën e monumenteve kulturo-historike që do të duhej të kenë status të mbrojtjes;

Trashëgimia natyrore

Komuna e Kamenicës kryesisht ka qenë njohur për nga industria e materialit ndërtimor, por eksitojnë edhe kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, zejtarisë e në veçanti për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror.

Kamenica vlerësohet si trevë e pasur me pyje, kullosa, livadhe, ujera të rrjedhshme dhe burimore me florë dhe faunë të pasur dhe natyrë të pastër larg ndikimeve industriale. njohura gjithandej në rajon, e bëjnë këtë trevë joshëse për vizita.

Ato që e bëjnë të veçantë në këtë aspekt janë :

-Mali KIKA(2499m') – një ndër majat më të larta të maleve të komunës së Kamenicës stinës. Është një zonë shumë joshëse për turistë, me pyjet e dendura përreth, me ujë të pastër etj. Gjatë stinës së verës, Mali Kika me rrethinë merr pamje magjepsëse dhe tërheqëse për vizitorë të ndryshëm.

Në takimet konsultative për rajonin e Gjilanit si rekomandim nga grupet mjedisore është dalë si propozim që kjo zonë malore të shfrytëzohet për ndërtimin e një enti shëndetësor për pacient që vuajnë nga frymorja dhe nga sëmundjet e ndryshme (sanatorium). Ky regjion shquhet me natyrë të begat (botë të pasur bimore dhe shtazore dhe ujëra burimore)

Pejsazhe të natyrës në komunën e Kamenicës janë prezentë ne shumë pjesë ne viset kodrinore-malore te komunës me theks te veçantë është Gryka e Gjyrishecit.

Monument karakteristik natyror ne komunën e Kamenicës është edhe Guri i Madh në Busavat shih foton:

Në këtë rajon nuk kemi ndonjë monument natyror me status të mbrojtjes .Pasuritë pyjore të, vargmalet e shumta me pasuri ujore dhe peizazhe natyrore, janë potenciale të mjaftueshme për zhvillimin e turizmit në këtë komunë.

Rekomandim:

- Të respektohen parimet udhëzuese të politikës për mbrojtjen e mjedisit;
- Të bëhet inventarizimi i monumenteve natyrore dhe të propozohen zonat për mbrojtje.
- Respektimi i legjislacionit si ligjit për planifikim hapësinor, ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe ligjit për mbrojtjen e natyrës do të mundësonte mbrojtjen e mjedisit konform zhvillimit të qëndrueshëm në Kosovë;
- Bashkëpunimi i pushtetit qendror (MMPH, MKRS dhe MTI), Instituteve për mbrojtjen e mjedisit dhe pushtetit lokal (drejtoritë për mjedis) është i domosdoshëm me qëllim të harmonizimit të aktiviteteve në mbrojtjen e trashëgimisë natyrore si potencial i zhvillimit të gjithmbarshëm të Kosovës;
- Të stimulohet zhvillimi i turizmit me investime në infrastrukturën teknike dhe në objektet turistike përmes promovimit të vlerave të trashëgimisë natyrore që i ka kjo anë. Kjo do të ndikonte edhe në rritjen e zhvillimit të gjithmbarshëm të komunës në veçanti dhe të Kosovës në përgjithësi.

ANALIZA HAPESINORE



► Busavat: Guri i madh (Monument natyre)

6. Humbja e tokës bujqësore

Kosova ka një sipërfaqe prej afro 1.1 milion ha, nga e cila 53 % është tokë bujqësore. Prej sipërfaqes së përgjithshme të tokës bujqësore, 88 % është në pronësi private dhe 12% është në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore. Në Kosovë dendësia e popullsisë është 204 banorë/km². Sipërfaqja e tokës punuese për kokë banori vlerësohet se është rreth 0.15 ha.

Viteve te fundit humbja e tokës bujqësore është shumë intensive. Nuk ka të dhëna të sakta por vlerësohet se në Kosovë humbin rreth 2600-3000ha në vit. (burimi: MBPZHR , Raport mbi gjendjen e tokave bujqësore që janë atakuar nga ndërtimet e egra dhe propozimi i masave për parandalimin e kësaj dukurie).

Në mungesë të mbrojtjes institucionale, Kosova humbë tokë bujqësore në forma të ndryshme.

Mënyrat e humbjes së tokës bujqësore janë:

Humbjet e përhershme të tokës (Rrugët, Akumulimet e ujit, Aeroportet, Ndërtesat e mëdha);

Humbjet e përkohshme të tokës (Mihjet sipërfaqësore, Eksploatimi i rërës, zhavorrit dhe argjilës, Mbeturinat industriale, Mbeturinat komunale, Procesi i erozionit, degradimit, gërryerjet e lumenjve etj.).


Tokat e klasës te I, II, III dhe IV janë toka te mbrojtura me ligjin mbi tokat bujqësore.

Ruajtja e tokës bujqësore ne K. Kamenicës për dallim nga komunat tjera është e lakmueshme edhe pse ne komunë kalojnë rrugët regjionale dhe ato lokale ndërtimet janë te kontrolluara.

Komuna e Kamenicës favorizohet nga kushtet e përshtatshme natyrore (klima, ndërtimi pedologjik, hidrografia) për zhvillimin e bujqësisë. Pjesa e ulët fushore e cila shtrihet përgjatë luginave lumore të Moravës, Krivarekës dhe lumit të Hogoshtit është tokë pjellore dhe me kushte të mira për kultivimin e kulturave bujqësore, kurse pjesët tjera të komunës kanë lartësi më të madhe mbidetare dhe konsiderohen si vise kodrinore-malore me toka më pak pjellore.

Rruga Petrovc-Dheu i Bardh ne dy anët e rrugës është ruajtur toka bujqësore nga ndërtimet ilegale dhe rruga Crep-Koretin është ruajtur toka bujqësore nga ndërtimet e pa kontrolluara .

► Fondi i tokës





Burimi: Drejtorati për bujqësi


ANALIZA HAPESINORE

Raporti përmblendhës i shfrytëzimit të tokës në K. Kamenicës³

Shfrytëzimi i tokës	ha
Fabrikë	6.48
Shtëpi-Ndërtesa	98.2
Oborre	341.7
Kantier-Punishte	0.09
Rrugë	1.93
Rrugë e rendit I	0.45
Rrugë e rendit II	0.68
Rrugë e rendit III	1.71
Rrugë private	41.58
Rrugë e pa kategorizuar	849.36
Lumë	917.57
Përrua	106.96
Jaz	3.89
Kanal	0.34
Rrugë	3.53
Mbushje	2.68
Madem guri	1.43
Madem rëre	42.93
Fushë sportive	0.31
Varreza	49.25
Kisha	0.05
Xhamia	0.08
Shkollë	0.33
Depo	0.11
Greminë	51.62
Gurishte	50.65
Kanale e mulli uji	0.15
Stacion benzine	0.14
Deponi hedhurinash	0.64
Tokë jo pjellore	204.37
Kënetë	1.48
Ara	16069.26
Kopshte	39.1
Pemishte	238.9
Vreshta	86.13
Livadhe	3306
Kullosa	9265.45
Male	20180.01
Gjithsej	51965.54



Tokë e punueshme në sektorin shoqërorë	320 ha
Tokë e punueshme në sektorin privat	16.221 ha
Kullosa	9.246 ha
Livadhet	3.297 ha
Pemë dhe vreshta	220 ha
Totali	29.304 ha



³ Burimi: Agjencia Kadastrale e Kosovë

ANALIZA HAPESINORE

Të dhënat e përgjithshme për vendbanimet

Përqindja e pjesëmarrjes së tokës bujqësore në tokën e përgjithshme të një vendbanimi në komunën e Kamenicës, dallon nga vendbanimi në vendbanim. Dhjetë vendbanime kanë kushte të volitshme për zhvillimin e bujqësisë në të cilat përqindja e tokës bujqësore sillet rreth 70% ose rreth 6978 Ha. Ku ç'do vendbanim ka mbi 500 Ha tok punuese bujqësore dhe shtrihen përgjatë luginave të lumenjve (Moravë, Krivarekë, dhe lumit Hogoshtë). Në 14 vendbanime kjo përqindje sillet 50-70% ku çdo vendbanim ka mbi 200-500Ha tok bujqësore që shtrihen përgjatë shtretërve të lumenjve.

Viset e Ultëta	>500 Ha	
Topannicë	730.59	88.69%
Ropotov e M	534.15	71%
Ranillug	619.94	59.01%
Rogoçicë	707.05	61.22%
Karaçevë e E.	549.46	48.07%
Hogoshtë	776.66	50.22%
Hodonoc	962.94	64.95%
Domorofc	587.07	57.50%
Kopernicë	606.08	72.74%
Gjithsej	6978.33	24.80% e sip bujqësore
	300- 500 Ha	
Berivojcë	337	41.5
Shipashnica e E.	340.24	36.16%
Kormijani	343.41	41.47%
Muqiverc	407.06	57.40%
Karaqeva II.	374.43	86.50%
Korminjani II	376.96	56.45%
Kolloleq	400.94	49.26%
Kamenicë	435.37	62.21%
Qarakoc	343.32	92.71%
Gjithsej	3358.73	11.94% e sip bujqësore
	Nën 300 Ha	
Bllatë	69.24	58.01%
Dajkoc	234.31	75%
Novosellë	137.18	89.54%
Petroc	279.96	77.51%
Ropotovë e Vogël	270.88	78.44%
Ruboc	189.95	50.41%
Shipashnica II	208.97	54.40%
Gjithsej	1390.49	4.94% e sip bujqësore

Në viset kodrinoro-malore shtrihen rreth 16408 Ha me pak kualitative por shumë e favorshme për profilizimin e bujqësisë sidomos për zhvillimin e blegtorisë është shumë e favorshme. Humbja e tokës bujqësore është prezentë në këtë komunë sidomos tek rritja e qytetit dhe ndërtimet përgjatë rrugëve kryesore.

Kjo dukuri negative për kohën në K. Kamenicës është stabile nga se vërehet që nuk është leju degradimi i sip. të tokave bujqësore përgjatë akseve rrugore.

Edhe pse të gjitha shënimet tregojnë se komuna e Kamenicës ka 28137 ha tokë bujqësore, gjendja në teren ndryshon dukshëm. Migrimet e popullatës nga fshati në qytet kanë rezultuar me zvogëlimin e dukshëm të sipërfaqeve të mbjellura me kultura lavërtarie. Mund të thuhet se sot sipërfaqja lavërtare është rreth 16000 ha në të cilën kultivohen kryesisht gruri dhe misri, perime etj Perimekultura në komunën e Kamenicës zhvillohet kryesisht në sipërfaqe të vogla dhe plotëson vetëm familjare dhe tepricat i dedikohet tregut vendor me rreth 41 Ha. Bazuar në kushtet e favorshme ekzistuese për zhvillimin e pemëtarisë dhe vreshtarisë, në vitet e fundit janë ngritur 26 plantacione të pemëve. Fondi i përgjithshëm është rreth 320 ha.

Kushtet fiziko natyrore janë shumë të favorshme për zhvillimin e kulturave pemëtarie dhe veshtare. Blegtoria ka kushte të mira të zhvillimit. Sipërfaqet me kullosa dhe livadhe janë në favor të zhvillimit të kësaj dege. Sipas Agjencionit Katastral të Kosovës sip. me livadhe në K. Kamenicës janë rreth 3400ha ndërsa me kullosa rreth 9300ha.

Fondi blegtoral në K. Kamenicës është shumë i vogël (rreth 20000krerë kafshë të imta dhe të trasha) krahasuar me mundësitë e zhvillimit të kësaj dege ekonomike.

ANALIZA HAPËSINORE

Viset kodrinoro malore	>500 Ha	% e sip.bujqësore
Bozhevc	506.12	61.10%
Busavat	576.16	54.05%
Poliçkë	648.61	66.05%
Cvirçë	630.28	60.11%
Desivojcë	680.16	42.13%
Gjyrishec	580.68	65.05%
Krilevë	586.24	34.77%
Tugjec	634.6	46.25%
Gjithsej	4842.85	17.21% e sip bujqësore

	300-500 Ha	
Feriqevë	415.89	65.25%
Tërstenë	442.46	44.33%
Hajnoc	350.01	25%
Bratillovc	324.13	74.40%
Bushincë	404.62	49.01%
Glllogoc	314.08	25.08%
Velegllava e E,	472.17	53.02%
Grizime	303.69	74.08%
Meshinë	476.4	58.98%
Miganoc	358.89	66.79%
Moqar	313.01	49.76%
Drenoc	317.43	75.40%
Zajqec	431.28	51.31%
Kostadincë	367.8	69.77%
Kranidell	376.93	38.17%
Lisockë	482.93	61.88%
Laqiq	463.41	50.43%
Gjithsej	6615.13	23.51% e sip bujqësore

	Nën 300 Ha	
Gragjenik	262.08	44.44%
Bolevc	248.99	37.30%
Carec	205.25	56.11%
Dazhnicë	259.78	62.50%
Gëmicë	246.57	20.30%
Gogollovc	137.06	58.01%
Hodec	292.72	80.81%
Huboc	354	80.30%
Kremenata I	225.53	32.70%
Kremenata II	68.97	31.42%
Leshtar	220.94	44.89%
Marocë	113.9	49.77%
Panqellë	153.94	59.53%
Rahovicë	172.31	35.75%
Rajanoc	297.99	69.01%
Sedllar	206.5	36.72%
Shahiq	108.36	69.23%
Stralicë	125.03	44.80%
Strezoc	299.85	25.59%
Tirincë	186.34	42.08%
Tomancë	185.06	68.51%
Vaganesh	136.12	30.90%
Veleglla II	98.06	33.20%
Vriqevc	174.66	41.07%
Zhuja	171.57	58.36%
Gjithsej	4951.58	17.59% e sip bujqësore

Shpeztaria – Dikur veprimtari e zhvilluar . Ekzistojnë kushtet e mira për zhvillimin e kësaj dege bujqësore me ngritje të mini-fermave. Sip. e mjaftueshme për kultura të drithërave është një shans i mirë i zhvillimit të kësaj veprimtarie.

Bletaria –

Veprimtari e favorshme dhe me parakushte të mira për zhvillimin e kësaj dege në këtë komunë është shumë pak e zhvilluar me vetëm 4500 zgoje bletësh. Në bazë të analizave hapësinore vendbanimet kodrinoro malore kanë predispozita shumë të favorshme për zhvillimin e kësaj veprimtarie.

Si në çdo komunë tjetër, edhe në këtë komunë tokave bujqësore po iu ndërrohet destinimi pa leje paraprake. Mbrojtja nga ndërrimi i destinimit të tokave bujqësore kërkon një angazhim shumë të madh duke filluar që nga strukturat më të larta shtetërore deri te ato komunale.

	Viset e ulta	Viset kodrinoro malore
> 500Ha	6978.33	4842.85
300-500Ha	3358.73	6615.13
<300Ha	1390.49	4951.12
Gjithsej	11727.55	16409.1

Burimi i informatave : Drejtoria për Bujqësi



Rekomandimet :

- Zhvillimi i politikave për parandalimin e humbjes së tokës bujqësore, si resurs shumë i rëndësishëm në këtë rast për qytetin e Kamenicës dhe komunën në përgjithësi;
- Zoonimi i territorit të komunës (përcaktimi i zonave të cilat do të përdoren vetëm për kultivimin e kulturave bujqësore dhe jo për qëllime tjera);
- Me rastin e zgjerimit të qytetit rekomandohet të shfrytëzohen anët verilindore dhe perëndimore ndërsa për vendbanimet tjera, rekomandohet që zhvillimet të bëhen në toka

ANALIZA HAPESINORE

të kategorive të ulëta duke i ruajtur ato të kategorive I, II, III dhe IV si dhe tokat nën ujitje, për të njëjtat rekomandohet të krijohen tampon zonat që parashihen edhe me ligjin për tokat bujqësore.

- Që të arrihet një zhvillim i mirëfilltë i bujqësisë në komunë, kërkohet mbrojtje dhe shfrytëzim racional i tokës bujqësore, organizim i mirë shoqëroro-ekonomik, investime në mjete dhe teknologji të punës, teknologji bashkëkohore për një bujqësi intensive, hapje e mini-fabrikave për përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale.
- Kategoria V-VIII e tokës brenda sipërfaqes kodrinore të shfrytëzohet për ndërtim industrial, kullot ose pyje.
- Tokat që kanë pjerrtësi > 15% propozohen për kullosa dhe pyje me qëllim të parandalimit të erozionit dhe shkatërrimit të pjesës pedologjike dhe trollit.
- Shfrytëzimi tokës në fusha lumore të lumenjve kryesor duhet të kufizohet me kullosa të përhershme ose me pyje me qëllim të mbrojtjes së tokave të lëvrueshme nga erozioni, shpërlaja por edhe nga vërshimi.
- Erozioni duhet të kufizohet me brigjet e lumenjve kryesor me mbjellje të drunjve që do ta mbulonin sipërfaqen prej 10 m nga largësia e lumit.




► Foto – Rruga Crep – Koretin – Kamenicë (hyrja në qytet)

Njëra nga dëshmitë se në komunën e Kamenicës niveli i humbjes së tokës bujqësore është më i ulët se mesatarja e Kosovës.

7. Banimi - kualiteti i banimit

Çështja e banimit për çdo ditë e më shumë po bëhet më akute. Me shtimin e lartë të popullsisë (natyror) rriten kërkesat për banim.

Me hartimi i planeve zhvillimore komunale do të ndikohet në rregullimin e kësaj çështje, do të mundësohet funksionimin dhe shfrytëzimin racional i hapësirës. Në zonat për të cilat nuk ekzistojnë planet urbanistike, banimi po përcillet me probleme serioze. Raporti në mes të banimit në ndërtesat një banesore dhe atij në ndërtesat shumë banesore në komunën e Kamenicës (Kamenicës) është : rreth 94.6 % banim individual (në ndërtesat një banesore) dhe 5.40 % banim kolektiv (në ndërtesat shumë banesore). Një raport i tillë, po ndikon në mënyrë direkt në humbjen e tokës kualitative bujqësore. Mungesa e planeve dhe pamundësia e organeve komunale për tu përgjigjur në kërkesa të shumta për ndërtim po ndikon në shfrytëzimin joracional të tokës. Shpërndarja e banimit në distanca të mëdha në hapësirë pamundëson që qytetarët të kenë qasje të kënaqshme në shërbime publike (infrastrukturë, shkollë, ambulatë, etj).




Po të analizojmë kualitetin e banimit në aspektin gjeneral, del se kualiteti më i ulët është i shprehur në zonat rurale, në vendbanimet me largësi më të madhe nga qendra (Qyteti). Arsyeja qëndron në atë se këto vendbanime i kanë më pak të zhvilluar shërbimet publike, prandaj si pasojë e gjithë kësaj është i shprehur depopullimi i vendbanimeve. Që të kemi pasqyrë më të qartë të kualitetit të banimit është e domosdoshme të njihet gjendja e infrastrukturës teknike, shërbimeve komunale, hapësirave përcjellëse etj, të cilat në fund do të na japin rezultatin e kualitetit të banimit dhe kualitetin e jetës në përgjithësi. Çështja e banimit trajtohet nga aspekte të ndryshme si kualiteti i jetës, të ardhurat, shkalla e varfërisë, punësimit,

ANALIZA HAPESINORE

arsimimit, infrastruktura teknike, shërbimet publike etj. Të gjitha këto janë të ndërlidhura dhe kanë ndikim të drejtpërdrejtë në kualitetin e banimit.

Kamenica si komunë numëron rreth 56.000 banorë nga të cilët ~ 22.26 % jetojnë në qytetin e Kamenicës, ndërsa 77.74 % e popullsisë e shpërndarë në gjithsej 75 vendbanime tjera. Është me rëndësi të theksohet se në komunën e Kamenicës kemi vendbanime të cilat nuk kanë asnjë banor si pasojë e depopullimit të popullsisë. Vendbanimet të cilat tani më nuk shënojnë asnjë banorë janë : Koromnjani i Ulet, Kremenata II dhe Velegllava më pastaj kemi edhe vendbanime të cilat kanë numër të vogël të banorëve si : Bratillovc me 14 banorë, Vaganeshi me 21 banorë, Meshina me 31 banorë e kështu me radhë ndërsa numër më të madh të banorëve ka vetë qyteti i Kamenicës rreth 12.500 banorë. Nëse e vrojtojmë dhe analizojmë gjendjen në këtë komunë do të mësojmë se vetë qyteti është më joshës për banorët e kësaj ane për arsye se ofron shërbime më të mira dhe standard më të lartë për jetesë. Në bazë të fotografive ajrore karakteristika kryesore e vendbanimeve është se ato janë të tipit të shpërndarë dhe i përgjigjen karakteristikave të përgjithshme të vendbanimeve në Kosovë. Vlen të theksohet se shpërngulja e popullsisë nga viset rurale kanë lëvizur përveç në qytetin e Kamenicës edhe në qytete tjera si në Gjilan, Prishtinë etj.

Zgjerimi ngesinor i qytetit te Kamenices (1980 - 2000)



Në këtë hartë është paraqitur rritja e qytetit të Kamenicës dhe zhvillimi i tij nga vitet 1980 deri në vitet 2000. Me anën të këtyre analizave na paraqitet rritja njëzetvjeçare e qytetit për më tepër se 60.00 ha.

Në zgjerimin e qytetës në të ardhmen rëndësi të madhe duhet kushtuar edhe zgjerimit kah ana perëndimore, jugperëndimore dhe verilindore me qëllim që toka e punuar ajo veriore dhe juglindore të mos shfrytëzohet për ndërtim të objekteve⁴.

⁴ Kallaba M, Punim diplome, Prishtinë 2003.

ANALIZA HAPESINORE

Rekomandimet

- Krijimi i një baze të dhënash për zonat e banimit,
- Hartimi i planeve zhvillimore komunale dhe urbane, të cilat do ti jepnin një kahe të mirë zhvillimit të komunës,
- Promovimi i politikave në favor të vendbanimeve të koncentruar duke pasur për synim mbrojtjen tokës kualitative bujqësore,
- Përkrahje ndërtimit të ndërtesave shumë banesore,
- Përqendrimi i investimeve ne zonat rurale,
- Sigurimi i banimit social për të pastrehët,
- Krijimi i zonave të dedikuara për sport dhe rekreacion për secilin vendbanim,
- Krijimi i zonave të dedikuara për parking të automjeteve për vendbanimet urbane etj.



ANALIZA HAPESINORE

8. Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni



► Foto: Qershor 2007

Komuna e Kamenicës ka një rrjet lumenjsh të shpërndarë nga të cilët më të rëndësishmit janë: Lumi Krivareka, lumi i Hogoshtit dhe lumi i Desivojcës . Të gjithë këta lumenj derdhen në lumin Morava. Në këtë komunë ekziston dhe liqeni në fshatin Ruboc. Lumenjtë e Kamenicës rrjedhje më të mëdha kanë gjatë muajit shkurt, mars dhe maj, kurse rrjedha më të vogla gjatë muajit gusht dhe shtatorë.

Komuna e Kamenicës është e pasur me burime ujore. Në bazë të dhënave të Bazës së Hidroekonomisë së Kosovës në territorin e Kamenicës janë të rrezikuara rreth 1200 Ha.


Në territorin e komunës së Kamenicës ujërat sipërfaqësor përfshijnë një sipërfaqe prej 1021 ha ose 1.97% e sip. të përgjithshme e komunës.



ANALIZA HAPESINORE

Qeveria Komonale e Kamenicës i ka në plan t'i realizojë 4 projekte për lumenjtë, që presin të realizohen deri në vitin 2010:

- Rregullimi i shtrazit të lumit dhe pastrimin e saj të lumit Krivareka Hajnovc-Domarovc
- Rregullimi i shtrazit të lumit dhe pastrimin e saj të lumit Hogoshtë Hogosht-Domarovc
- Rregullimi i shtrazit të lumit dhe pastrimin e saj të lumit Karaqevë Karaqev-Katunisht
- Rregullimi i shtrazit të lumit dhe pastrimin e saj të lumit Rubovc



Lumi Krivareka deri në derdhjen e tij në lumin Morava, kryesisht kalon pjesë të banuara dhe pranë tokës bujqësore, Meqenëse ka gjatësi të madhe, gjatë vërshimeve shpeshherë shkakton dëme të konsiderueshme. Projekti „Rregullimi i shtrazit të lumit“ ka arsyeshmëri të plotë si në aspektin ekonomik po ashtu edhe në aspektin e sigurisë së popullsisë nga vërshimet.

ANALIZA HAPESINORE

Realizimi i këtij projekti do të parandalonte përmbytjen e tokave bujqësore dhe do të mbronte vendbanimet, rrugët nga vërshimet. Gjatë të reshurave të mëdha, lumenjtë Krivareka dhe lumi i Hogoshtit rregullisht dalin nga shtrati duke shkaktuar dëme të mëdha materiale.

Rregullimi i shtratit të lumit krijon mundësi të mira edhe për shfrytëzimin e tokës përgjatë tij për nevoja të bujqësisë.

Lumi Morava i cili kalon nëpër territorin e komunës së Kamenicës ka rrjedhje mesatare rreth $6.1\text{m}^3/\text{s}$. Gjatë stinëve me të reshura shkakton dëme të mëdha duke dalur nga shtrati dhe vërshuar një numër të madh të tokave bujqësore. Dëmtimi i argjinaturave nga faktori natyror dhe antropogjen ndikon në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë së vërshimeve sidomos në fshatrat Petroc, Ranillug, Koromjan i epërm Koromjan i poshtëm si dhe në Crep dhe tek Dheu i Bardh.

Faktorët që ndikojnë në rritjen e shkallës së rrezikshmërisë nga vërshimet janë :

- Çrregullimi natyror i shtratit të lumit (nxjerrja ilegale e inerteve),
- Ngushtimi i shtratit të lumit nga uzurpimet
- Hedhja e mbeturinave të ngurta në shtretërit e lumenjve,
- Mbjellja e bimëve të larta si dhe atyre të vetë-rritura pranë brigjeve të lumenjve etj
- Shkatërrimi i objekteve hidroteknike dhe moskujdesi i vazhdueshëm (argjinaturat) etj.

Rekomandimet :

- Rregullimi i shtretërve të lumenjve në baza natyrore
- Pastrimi i shtratit të lumit nga mbeturinat e ngurta
- Mirëmbajtja dhe ndërtimi i argjinaturave (sipas nevojës)
- Përcaktimi i kriterëve profesionale për shfrytëzimin e inerteve si dhe ndalimi i shfrytëzuesve ilegal.
- Eliminimi i pengesave natyrore përgjatë shtratit të lumit etj.(Urgjent në lumin Krivareka)
- Krijimi i zonave të gjelbra (mbjellje e drunjve) 10m nga lumi

► Foto - Masa mbrojtëse për parandalimin e vërshimeve dhe erozionit në lumin Hogoshtë



ANALIZA HAPESINORE

Erozioni


Erozioni rrezikon natyrën dhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara të njeriut. Ai manifestohet me degradimin e tokës bujqësore dhe pyjore, të bimëve, me bartjen dhe akumulimin e materialit eroziv, i cili ndikon negativisht në tokat bujqësore dhe në vendbanime.

Rreth 6000km² ose 56% e territorit të Kosovës është i rrezikuar nga kjo dukuri natyrore të shkallës së I, II dhe III (I - erozion shumë i fortë, II - erozion i fortë dhe III - erozion i mesëm).

Edhe në territorin e komunës së Kamenica është prezent faktori natyror erozioni që për pasojë ka humbjen e tokës bujqësore dhe dëmet në ekonomitë familjare.

Nga një shkallë e lartë e rrezikshmërisë erozive janë të përfshirë 25.050 ha ose 48% e sipërfaqes së komunës që i takojnë shkallës me erozion të fortë dhe shumë të fortë. Shkalla e rrezikshmërisë është në rritje si pasojë e faktorëve natyror dhe faktorit njeri. Nga shkalla më e lartë e rrezikshmërisë që e ka kategoria e erozionit shumë të fortë janë të përfshirë 11.550 ha tokë. (Shih hartën).

Shkalla e erozionit	Sip. ha	%
Pa erozion	0	0
Erozion shumë i dobët	0	0
Erozion i dobët	11550	22
Erozion i mesëm	15900	30
Erozion i fortë	13500	26
Erozion shumë i fortë	11550	22




► Harta - Erozioni në komunën e Kamenicës

ANALIZA HAPESINORE

Faktorët që ndikojnë në shkallën e lartë të erozionit janë :

- Kushtet meteorologjike
- Pjerrtësia e terrenit
- Përbërja gjeologjike
- Flora dhe fauna
- Shkatërrimi i pyjeve
- Shfrytëzimi i inerteve etj
- Shfrytëzimi jo racional i resurseve natyrore
- Mënyra e shfrytëzimit të tokave bujqësore



Rekomandimet për erozion:

- Meliorimi i pyjeve
- Ndërtimi i brezave mbrojtës në shpatet e rrëpishme
- Parandalimi i prerjes ilegale të pyjeve etj.
- Tokat që kanë pjerrtësi të terrenit mbi 15% të mbillen me kullosa ose edhe me pyje.



► Masa Mbrojtëse anti-erozive: Ndërtimi i pritave - Hogoshtë 2007

ANALIZA HAPESINORE

9. Ndotja dhe degradimi i mjedisit

Uji – Territori i komunës së Kamenicës ka një rrjet hidrografik, i cili i takon pellgut të Detit të Zi. Në komunë janë dy lumenj Krivareka me degët e saja lumë burimor dhe Morava e Binçës që kalon nëpër territorin e Komunës. Lumi Krivareka buron në malet e Gollakut dhe deri në hyrje të fshatit Hajnovc i takon lumenjve me ndotje të kategorisë së parë (lum i pastër). Prej fshatit Hajnovc e deri në hyrje të Kamenicës i takon shkallës së dytë të ndotjes IIa (ndotje e lehtë) Pas daljes nga vendbanimi i Kamenicës e deri në bashkim me lumin Morava i takon shkallës së dytë të ndotjes IIb, shndërrohet në lum me ndotje të kategorisë II-b (ndotje e lartë). Shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale pa asnjë trajtim paraprak lëshohen në Lumin Krivareka dhe rritë shkallën e ndotjes së lumit. Lumi Hogoshtë është i pastër deri në hyrje të vendbanimeve (ujera burimore) pas shkarkimit të ujërave të zeza dhe hedhjeve të mbeturinave në shtretërit e lumenjve kalon në shkallën e ndotjes IIa. Ndotja e ujit të lumit Morava është pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza të qytetit të Vitisë, Gjilanit dhe fshatrave që shtrihen përgjatë lumit si dhe objekteve industriale.

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumenjve. Çdo banor shkarkon 16.46m^3 ujëra të zeza.

Vetëm Kamenica si qytezë me 12.500 banorë shkarkon 6.5 l/s ose 205.750m^3 /vit ujëra të zeza të patrajtuara në lum brenda vitit pa llogaritur këtu objektet shoqërore, industriale etj.

Përveç shkarkimit të ujërave të zeza, lumenjtë ndoten dhe degradohen edhe nga mbeturinat që i hedhë popullata lokale, nxjerrja ilegale e rërës, shkatërrimi i florës pranë brigjeve të lumenjve, shpëlarja e tokës gjatë reshjeve atmosferike, nga objektet industriale etj.

Në bazë të Strategjisë për trajtimin e ujërave të zeza të punuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Finlandës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Departamenti i ujërave, ekzistojnë dy variante për trajtimin e ujërave të zeza:

- Varianti 1 - Trajtim i decentralizuar i ujërave të zeza sipas të cilit çdo qytet / fshat e ka impiantin e vet për trajtimin e ujërave të zeza dhe

- Varianti 2 - Trajtim i centralizuar i ujërave të zeza me vetëm nga një impiant trajtues të ujërave të zeza në secilën prej shtatë kompanive regjionale ujore të cilët më vonë do të trajtonin edhe ujërat fekale të zonave rurale. Sipas këtij varianti, komuna e Kamenicës parashihet të përfshihet në impiantin regional të Gjilanit që është planifikuar të ndërtohet afër fshatit Velekincë afër lumit Morava e Binçës .

Rekomandohet për Komunën e Kamenicës të përcaktohet për variantin e parë dhe komuna të ndaj sipërfaqe tokësore për ndërtim impianti në mes fshatit Koromjan dhe Dheut të Bardhë. Arsye është për shkak të konfiguracionit të terrenit.



ANALIZA HAPESINORE

Parametrat fizik	Lumi lakuar,Dardan,Hyrje			Lumi lakuar,dardan,Dalje			VML
	VEMin	VEMax	VMV	VEMin	VEMax	VMV	
Ajri t°	17.3	29.5	22	17.3	29	22.9	
Uji t°	6.6	21.8	16.4	7.1	21.8	15.7	28
Ngjyra Pt/Co	10	103	45.2	14	141	69.6	20
Aroma	pa	pa	pa	pa	pa	pa	pa
Turbullira NTU	0.37	174	31.5	9.1	122	53.8	100
TDS	189	383	310	363	549	427	1000
Pëq.elektrike µs/cm	377	763	584	480	1092	770	2000
Parametrat kimik							
Vlera pH	7.6	8.8	8.2	7.7	8.4	7.9	5.5-9.5
Oksigjeni i tretur	2.1	12.9	7.28	3.1	10.4	5.81	>3
Ngopshmëria me O ₂	26.1	135	76	35.7	101.2	58.4	>30
Fortësia e përgjithshme.	17.8	17.8	17.8	17.92	17.92	17.92	30 d
Bikarbonatet HCO ₃ ⁻	232	232	232	238	238	238	653
Materjet e suspendu.	0	92	14	0	48.5	14.3	<80
SHKO	0	114	26.4	6.3	64	33.6	<160
SHBO ₅	0	25.2	8.3	2.7	30	12.38	<40
Karboni total organik	0	18.6	5.74	1.9	20	8.4	<30
Detergjentet	0	0	0	0	0.1	0.0125	<2
Amonjaku NH ₄ ⁺	1	15.9	4.1	1.38	34.8	9.7	<15
Nitratet NO ₃ ⁻	0	1.3	0.27	0.7	8.4	3.6	<50
Nitritet NO ₂ ⁻	0.011	0.13	0.08	0.14	1.5	0.61	<0.6
Cianuret CN ⁻	0.042	0.042	0.042	0.047	0.107	0.077	<0.05
Kloruret Cl ⁻	2.9	6.5	4.8	6	79	19.4	<1200
Fosfatet PO ₄ ³⁻	0.013	0.36	0.22	0.072	0.424	0.314	<10
Magnezi Mg							
Kalciumi Ca							
Hekuri Fe	0.032	0.25	0.15	0.036	0.39	0.158	<2
Mangani Mn	0.053	0.69	0.28	0.178	1.22	0.55	<2
Bakuri Cu	0	0	0	0	0	0	<0.1
Kromi Cr	0	0	0	0	0	0	<0.2
Zingu Zn	5	5	5	1	1	1	<0.5
Fenolet H ₈ H ₅ OH							<0.5
Klori Cl ₂	0.03	0.23	0.09	0.053	0.22	0.137	<0.2

Burimi MMPH-IHMK

Ajri – sa i përket çështjes së ajrit, për shkak të mungesës së monitorimit, mund të konstatojmë se mesatarja e ndotjes së ajrit është përafërsisht e ngjashme me ndotjen në komunat tjera të territorit të Kosovës.


Toka – Ndotja e tokës bëhet nga hedhja e pakontrolluar e mbeturinave në disa vendbanime në pjesën veri – lindore të komunës, shkaktar tjerë të ndotjes janë edhe rrjedhjet e ujërave të zeza.

Rekomandimet:

- Mënjanimi i mbeturinave në të gjitha vendbanimet ku janë të grumbulluara
- Riciklimi i mbeturinave

10. Shfrytëzimi joracional i resurseve natyrore

Komuna e Kamenicës hynë në radhën e komunave të pasura me resurse natyrore, si: ujëra, pastaj tokë bujqësore, kullosa, livadhe, pemë dhe perime me një sipërfaqe prej 29.304 ha, si dhe florë dhe faunë të llojllojshme.



Pylltaria – kjo komunë disponon me një fond prej 21.876ha pyje dhe 4.982ha sipërfaqe të zhveshura, të cilat në të kaluarën ishin të mbuluara me pyje cilësore. Sipërfaqja e përgjithshme në sektorin shoqëror dhe privat është 26.798ha, masa drunore është 942.092m³, shtimi vjetor 21.897m³, shtimi 10 vjeçar është 191.319m³.

Shfrytëzimi joracional ndodh tek pyjet, ekzistojnë katër regjione të shtrirjes së pyjeve: Shipashnica, Guri i Zi, Kamenica dhe Ranillugu.

Pyjet e dëmtuara për vitin 2004 në rajonin e Shipashnicës arrijnë vlerën 209.14 m³, në rajonin e Gurit të Zi 23.61 m³, në rajonin e Kamenicës 70.19 m³, kurse në rajonin e Ranillugut 230.64m³.

Pyjet e dëmtuara për vitin 2005 në rajonin e Shipashnicës arrijnë vlerën 325.20 m³, në rajonin e Gurit të Zi 15.36 m³, në rajonin e Kamenicës 323.28 m³, kurse

në rajonin e Ranillugut 259.14 m³. Pyjet e dëmtuara për vitin 2006 në rajonin e Shipashnicës arrijnë vlerën 257.62 m³, në rajonin e Gurit të Zi 253.09 m³, në rajonin e Kamenicës 75.04 m³ dhe në rajonin e Ranillugut 150 m³. Komuna ka edhe resurse nëntokësore, por të cilat momentalisht nuk shfrytëzohen.

Gurthytesit janë të koncentruar në tri vendbanime: Strezofc, Busovatë dhe Bozhevc, që funksionon në mënyrë legale, po ashtu edhe eksplotimi i rërës dhe zhavorrit bëhet në mënyrë legale. Pastaj kemi edhe akumulacionin e inerteve dhe një deltë, të cilat në këtë pjesë paraqesin probleme ndërkuftare. Prandaj kërkohet që urgjentisht të bëhet një marrëveshje ndërmjet komuniteteve në mënyrë që kjo sasi e inerteve të hyjë në përdorim për nevoja të ndryshme të tyre dhe njëkohësisht të bëhet pastrimi i shtratit të lumit dhe largimi nga sipërfaqja e tokës në mënyrë që kjo tokë të shfrytëzohet për nevoja tjera në radhë të parë për qëllime bujqësore.

Rekomandimet

- Shfrytëzimi racional i resurseve pyjore
- Ripyllëzimi i sipërfaqeve të zhveshura nëpër pyje
- Mënjanimi i deltës dhe inerteve të grumbulluara

- Rehabilitimi i tokës me parë të mbuluar me inerte

I I. Zhvillimi i pabarabartë ekonomik

Komuna e Kamenicës shtrihet ne pjesën Lindore të Kosovës dhe ka një sipërfaqe prej 522.2 km². Komuna e Kamenicës ka 76 vendbanime, me numër të popullsisë rreth 56,147 banorë. Dendësia e banorëve për një kilometër katror është 107.5 banorë/km². Para periudhës se luftës në komunën e Kamenicës kanë qenë disa ndërmarrje kryesisht industriale që ishin funksionale, si “Sintermagneziti” Kamenic – Berivojc, “Qeramika” – Berivojc, fabrika e materialit ndërtimor në Crep dhe “Trepça Plast” në Topanic. Prej tyre vetëm fabrika e materialit ndërtimor punon edhe sot e kësaj dite si dhe Trepça Plast e cila tani është fabrikë e birrës. Komunën e Kamenicës e përshkruajnë rrugë të nivelit nacional, regjional dhe sigurisht edhe rrugët lokale. Kjo komunë takohet me komunat shqiptare të Serbisë Jugore, siç janë Bujanoci dhe Mendvegja. Gjithashtu në këtë komunë ndodhet pika doganore e Konçulit, ku ne vitin 2005 janë realizuar rreth 50 milion EURO nga Shërbimi Doganor i Kosovës. Nga 76 vendbanime gjisej që ka komuna e Kamenicës, në tetë vendbanime nuk ka asnjë lloj biznesi, 11 prej tyre kanë nga nje biznes, 5 prej tyre kanë nga 2-3 biznese dhe 28 prej tyre kanë mbi 4 biznese te përqendruara ne vendbanim. Numri më i madh i bizneseve është i përqendruar në kryeqendrën komunale, Kamenicë(349), Rogoqicë(128) dhe Koretin(69). Përveç bizneseve të vogla dhe të mesme të cilat janë pjesa aktive dhe kryesore e jetës në komunën e Kamenicës, një rol shumë të madh luan edhe diaspora e kësaj ane e cila jeton dhe punon në botën perëndimore. Prania e tyre gjatë sezonit të verës është pjesë vitale e ekonomisë së vogël dhe po ashtu roli më i madh është investimi i cili bëhet kjo diasporë në territorin e kësaj Komune. Bazuar në regionalizimin e Kosovës sipas potencialit të zhvillimit ekonomik, komuna e Kamenicës është në grupin e komunave me zhvillim mesatar, sikurse komuna e Vitisë, Lipjanit, Klinës, Suharekës, etj. Sipas sektorëve të veprimtarive ekonomike sektori i Terciar është më i zhvilluar, me pjesëmarrje prej 88.62% të gjitha bizneseve, mandej vjen sektori Kuartar, me 5.03% te bizneseve. Kjo edhe dëshmon se natyra e ekonomisë në këtë komunë është kryesisht e mbështetur në ekonomi të vogël ose në biznese të vogla e më pak ne biznese të mesme.

Tabela nr.1

Sektori	Numri dhe % e bizneseve
I	22
%	2.21
II	33
%	3.32
III	880
%	88.62
IV	50
%	5.03

Tabela nr.2

Sektori	Nr dhe % e te punësuarve
I	49
%	3.38
II	177
%	12.23
III	1134
%	78.37
IV	53
%	3.66

Kurse, numri më i madh i të punësuarve është po ashtu në sektorin Terciar, me 78.37% të numrit të përgjithshëm të punësuarve, mandej vjen sektori Sekondar, me 12.23% ndaj totali, kjo pjesëmarrje e bizneseve në këtë sektorë tregon që ndërmarrjet e mesme i takojnë kryesisht këtij sektori.


Bazuar ne raportin e MEF, buxheti i komunës së Kamenicës për vitin 2006 ka qenë 4,286,442 milion euro, ndërsa buxheti i vlerësuar për vitin 2007 është 4,358,779 milion euro, që do të thotë se në vitin 2007 komuna e Kamenicës ka 72,337 mijë euro më shumë se në vitin paraprak. Nëse e ndajmë këtë buxhet për kokë banori për një vit 87.73 euro, kurse shpërndarja për kokë banori për një ditë është 0.24 euro. Raporti në mes të hyrave vetanake dhe granateve qeveritare është shumë i madh; 12.35% e të hyrave vetanake, me 87.65% të granateve qeveritare. Ky tregues tregon se sa e pa fuqishme është komuna ekonomikisht, dhe po të mos ishin granatet qeveritare atëherë për përmbushjen e obligimeve të shpenzimeve operative as që mund të flitej. Numri gjithsej i bizneseve është 993, mesatarja që paguan çdo

ANALIZA HAPESINORE

biznes për një vit në komunën e Kamenicës është 536.5euro. Kjo është shuma që komuna siguron nga të hyrat vetanake, duke mos përfshi tatimet e pronës dhe banimit.

BUJQËSIA (sektori i primar)

Pjesëmarrja e bujqësisë në përgjithësi ndaj sektorëve të tjerë të ekonomisë është 2.21% të numrit të përgjithshëm të bizneseve dhe 3.38% të numrit të punësuarve në këtë sektorë. Kontributi i këtij sektori i organizuar si biznes është shumë i vogël, mirëpo ky sektor është shumë më shumë i zhvilluar në kuadër të ekonomisë familjare si bujqësi ekstensive.



► Harta: Shpërndarja e bizneseve të sektorit primar (bujqësisë)

Nga analiza në hartë shihet që vetëm 10 vendbanime nga të gjitha vendbanimet e Komunës së Kamenicës kanë të zhvilluar bujqësinë si biznes, apo kanë ndërmarrje bujqësore. Vendbanimet e tjera kanë të zhvilluar sektorin primar si pjesë e ekonomisë familjare. Ky lloj aktiviteti brenda ekonomisë familjare është gjithnjë si ndihmës e vogël për ekonominë familjare, por jo edhe mbajtës i ekonomisë familjare, me përjashtim të rasteve në dhjet fshatra.






INDUSTRIA (sektori sekondar)

Ky sektor ka gjithsejtë 3.32% të të gjithë bizneseve të regjistruara dhe 3.38% të numrit të përgjithshëm të punësuarve në komunën e Kamenicës. Ky sektorë është i zhvilluar kryesisht në II vendbanime, dhe kryesisht në vendbanime të cilat shtrihen përgjatë rrugëve magjistrale dhe regjionale.


ANALIZA HAPËSINORE





►Harta: Shpërndarja e bizneseve të sektorit sekondar (bujqësisë)

SEKTORI TERCIAR (hoteleri)

Sektori i tretë ose terciar është sektori më i madh për nga numri i bizneseve por edhe i të punësuarve që tërheq ky sektorë. Ky sektorë pos hotelerisë në vete ngërthen edhe tregtinë dhe transportin. Pjesëmarrja për nga përqindja e bizneseve është me 88.62%, kurse për nga përqindja e të punësuarve është 78.37%. Ka edhe shtrirje hapësinore më të gjer se sa të gjithë sektorët e tjerë të veprimtarive.




ANALIZA HAPËSINORE



► Harta: Shpërndarja e bizneseve të sektorit terciar (hoteleri)

SEKTORI KUARTAR (bankat, arsimit dhe shëndetësia) - Ky sektor për nga numri i bizneseve natyrisht që është ndër sektorët e vogël, mirëpo për nga efekti në organizimin e aktiviteteve dhe zhvillimin afatgjatë të komunës është sektori më me rëndësi në komunën e Kamenicës. Ky sektorë përfshinë 5.3% ndaj numrit të tërësishëm të bizneseve dhe 3.6% të numrit të përgjithshëm të punësuarve. Zhvillimi në hapësirë i këtij sektori është kryesisht në vendbanimet e mëdha për nga numri i banorëve dhe numri i bizneseve të sektorëve të tjerë. Kjo lidhje kryesisht është në logjikën e ofrimit të shërbimeve të sektorëve të tjerë. Bizneset e sektori kuartar shtrihen kryesisht në 11 vendbanime, të cilat përfshinë 60% të territorit të komunës.



► **Harta: Shpërndarja e bizneseve të sektorit kuartar (bankat, arsimi dhe shëndetësia)**

Për të analizuar më mirë shpërndarjen hapësinore të bizneseve të këtij sektori në komunën e Kamenicës është punuar harta nr.4. Deri tani kemi kuptuar që ka zhvillim të pabarabartë në komunën e Kamenicës, ku janë të shprehura ato zhvillime.

Regjionalizimi i zhvillimit ekonomik

Regjionalizimi ka për qëllim të tregoj cilat territore kanë zhvillim të shkallës së caktuar. Në rastin konkret regjionalizimi është i shprehur me lokalizim pike, ku pika tregon nivelin e zhvillimit edhe të rrethit. Regjionalizimi i zhvillimit ekonomik në komunën e Kamenicës është i treguar në bazë të numrit të bizneseve.



Përgjithësisht mund të thuhet që aty ku është e koncentruar infrastruktura, dendësia e popullsisë, toka bujqësore, lumenjtë, aty është edhe niveli më i lart i zhvillimit ekonomik. Në bazë të këtyre parametrave, tregohet që cilat vendbanime gjenden në cilin nivel të zhvillimit ekonomik;

1. Shkalla 5 e zhvillimit ekonomik në kuadër të komunës - Kamenica, Rogoçica, Koretini
2. Shkalla 4 e zhvillimit ekonomik në kuadër të komunës - Berivojca, Ranilluku, Toponica, Hodanoci, Karaqeva, Shipashtica, Hogoshti, Desivojca
3. Shkalla 3 e zhvillimit ekonomik në kuadër të komunës - Petroci, Ropotova e madhe, Kormjani, Domoroci, Muqiverci, Dajkoci, Kopernica, Busovata, Strezovci dhe Krileva.

ANALIZA HAPËSINORE

- Shkalla 2 e zhvillimit ekonomik në kuadër të komunës - Glligoci, Panqela, Drenoci, Novosella, Kolloleqi, Kranidelli, Laciqi, Rubofci, Grizma, Hajnoci, Leshtari, Bushinca, Tugjeci etj.
- Shkalla 1 e zhvillimit ekonomik në kuadër të komunës: Janë te gjitha vendbanimet e tjera.

Përfundimisht mund të themi që hapësirat të cilat ndodhen përgjatë luginave lumore, tokave pjellore dhe të përshkuara nga rrugët e asfaltuara, kryesisht rruge magjistrale dhe rruge regionale kanë potencial më të madh zhvillimi të aktiviteteve ekonomike.



► Harta: Regjionalizimi i zhvillimit ekonomik ne komunën e Kamenicës.

ANALIZA HAPESINORE

Rekomandimet

- Asfaltimi i rrugëve që qojnë drejt fshatrave të malësisë
- Zhvillimi i programeve që kanë për qëllim kthimin e banorit në viset e malësisë
- Zhvillimin e programeve me qëllim të komunikimit dhe bashkëpunimit ndërkomunal
- Zhvillimi i programeve të zhvillimit rural me theks të veçantë në fshatrat që gjenden në nivelin e ulët të zhvillimit ekonomik
- Përforsimi i kushteve në vazhdimin e progresit në vendbanimet me zhvillim të lart
- Koncentrimi i bizneseve në trekëndëshin potencial të zhvillimit ekonomik (Kryqëzimi i rrugëve Kamenicë-Gjilan-Bujanoc) Crep

Te arriturat e pritura nga rekomandimet

- Kthimi i popullatës në viset rurale
- Aktivizimi i atyre viseve në të mirë të zhvillimit ekonomik, kulturor dhe mjedisor
- Rritja e kapaciteteve ekonomike për komunën e Kamenicës
- Hapja e një parku biznesi në Crep me qëllim të zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë në këtë komunë



12. Infrastruktura dhe shërbimet

Infrastruktura dhe shërbimet publike, në bazë të ndikimit që kanë në zhvillimin e një vendbanimi dhe banorëve të cilët jetojnë aty, shtrohet si një çështje e rëndësishme për analizë. Infrastruktura e një vendbanimi dhe shërbimet publike që u ofrohen banorëve, në masë të konsiderueshme paraqesin shkallën e zhvillimit të përgjithshëm të atij vendbanimi.

Analiza e zhvillimit të infrastrukturës dhe shërbimeve publike ngërthen në vete analizën e zhvillimit të rrugëve, transportit publik rrugor, kapaciteteve dhe pajisjeve për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, rrjetit të furnizimit me ujë, rrjetit të kanalizimit, sistemit të ngrohjes, telekomunikimit dhe të menaxhimit të mbeturinave.


Infrastruktura rrugore

Pas përfundimit të luftës infrastruktura rrugore në komunën e Kamenicës ishte mjaft e shkatërruar. Me shfrytëzimin e donacioneve të huaja dhe atyre të pakta vendore, u arrit që sado pak infrastruktura rrugore të përmirësohet. Ky përmirësim vërehet tek rrugët kryesore që lidhin Kamenicën me fshatra.

Sipas të dhënave nga institucionet zyrtare të komunës së Kamenicës nga gjithsej 215.3 km rrugë, vetëm 91.5 km janë rrugë të asfaltuara, ndërsa 123.8 km janë rrugë të pa asfaltuara. Prej rrugëve të paasfaltuara 36 km janë rrugë lokale. Në asfaltim e sipër është rruga Kamenicë-Busavatë e cila lidhë Kamenicën me Novobërdën. Kamenica lidhet me rrugën regjionale në relacionin Kamenicë - Bujanoc (Serbinë) dhe Kamenicë - Gjilan.

Lidhja e komunës me fshatra bëhet përmes rrugëve të asfaltuara, në relacionet:

- Kamenicë - Krilevë (ku përfshinë fshatrat Ajnoc, Strezoc)
- Kamenicë - Karaçevë e Epërme (Berivojcë, Koretin, Topanicë, Crep, Domaroc, Hodonoc, Novosellë, Karaçevë e Poshtme),
- Kamenicë - Hogosht (Rogoçicë, Muqivërc, Shipashnicë e Ulët, Shipashnicë e Epërme, Kolloleq, Kopërrnicë),
- Kamenicë - Kopërrnicë (ku përfshinë fshatrat Grizimë, Strelicë, Bosce),
- Kamenicë - Ranillug (Korminjan, Gllogoc, Ropotovë)



Kamenica ka lidhje edhe me të gjitha fshatrat tjera që nuk u përmendën, por përmes rrugëve dytësore dhe të pa asfaltuara.

Kryesisht vendbanimet në zonat e thella malore të komunës së Kamenicës nuk kanë rrugë të asfaltuara (shih hartën). Ky fakt sjell si pasojë ngecjen në zhvillimin e gjithmbarshëm të atyre vendbanimeve dhe kjo pastaj ka si pasojë migrimin e popullsisë nga ato vendbanime.

Nga gjithsej 76 vendbanime të komunës, 35 vendbanime (46%) kanë rrugë të asfaltuara, ku jetojnë rreth 80% të popullsisë së komunës, kurse 54% të vendbanimeve nuk kanë rrugë të asfaltuara.

Niveli i dëmtimit të rrugëve

Në bazë të analizave që janë bërë sipas nivelit të dëmtimit, rrugët i kemi ndarë në tre grupe: rrugë pak të dëmtuara, mesatarisht dhe shumë të dëmtuara.

I. Rrugët pak të dëmtuara janë:

- Petroc – Terminali doganor,

- Crep – Kamenicë – Strezoc,
- Kamenicë – Tugiec (edhe 5 km e paasfaltuar),
- Rruga e fshatit Shipashnicë,
- Kamenicë – Busavatë (edhe 2 km e pa kryer),
- Ranillugë - Petroc,
- Crep – Drenoc – Ropotovë e Madhe,
- Ranillugë – Tomancë – Panqell – Ropotovë e Madhe,

II. Rrugët mesatarisht të dëmtuara:

- Rogoçicë (Katushnicë) – Karaçevë e Poshtme,
- Kamenicë (rrugët lokale brenda qytetit),
- Berivojcë – Rajanoc,
- Tullar – Korminjan – Ranillugë – Glllogoc,

III. Rrugët shumë të dëmtuara:

- Dheu i Bardhë – Hogosht,
- Karaçevë e Poshtme – Karaçevë e Epërme

Rekomandimet

Lidhja me rrugë të asfaltuara midis vendbanimeve dhe po ashtu me qendrën komunale mundëson lëvizje më të lehtë dhe komunikim më të mirë midis tyre që si pasojë ka edhe shkëmbimin më të lehtë dhe të avancuar të të mirave e rrjedhimisht edhe ngritjen e mirëqenies. Kur në mungesë të rrugëve, lëvizja prej zonave më pak të zhvilluara në ato më shumë të zhvilluara është e vështirë, banorët nga ato zona ose shpërngulen ose mbesin të izoluar dhe ngecin në zhvillim si në aspektin social ashtu edhe atë ekonomik. Në zonat ku rrjeti rrugor është pak i zhvilluar edhe zhvillimi ekonomik, si industria, bujqësia dhe tregtia, është në nivelin mesatar të zhvillimit e kjo vlen edhe për zhvillimin social siç janë shërbimet shëndetësore dhe arsimore. Ndërtimi i rrugëve dhe lidhjeve të reja mundëson dhe krijon kushte që shërbimet të ngriten në nivel më të lartë duke ndikuar në këtë mënyrë në ndalimin e shpërnguljes së popullatës në kërkim të kushteve më të mira.

Zgjerimi i rrugëve të asfaltuara duhet të planifikohet të bëhet në ato drejtime të cilat mundësojnë një zhvillim më të madh të komunës, në relacionet e rrugëve më të frekuentuara, si ajo në drejtimin Kamenicë – Crep – Dheu i Bardhë – Terminali doganor dhe Crep - Gjilan. Duhet të bëhet asfaltimi i rrugëve lokale të cilat janë kryesisht të paasfaltuara e sidomos në viset malore dhe brezin kufitar në mënyrë që të ndalet shpërngulja e popullatës së këtyre viseve. Si prioritet duhet të jetë asfaltimi i rrugës Hogosht – Poliçkë – Desivojcë – Tërstenë.

Nga niveli i dëmtimit të rrugëve shihet se rrugët më të dëmtuara janë relacionet Dheu i Bardhë – Hogosht dhe Karaçevë e Poshtme – Karaçevë e Epërme, prandaj një ndër prioritet duhet të jetë asfaltimi i këtyre rrugëve.

Në mënyrë që të mundësohet një lidhje më e favorshme me qendrat e tjera komunale, në Planin Hapësinor të Kosovës është propozuar ndërtimi i rrugës që lidhë drejtpërdrejt Kamenicën me Podujevën (që kalon në relacionin Kamenicë – Strezoc – Krilevë – Podujevë), që mbyll rrugën unazore të qendrave të Kosovës.

Prioritetet e komunës për infrastrukturën rrugore

Prioritet i komunës është që deri më 2010 së paku edhe 15% e vendbanimeve të komunës të lidhen me rrugë të asfaltuara me qendrën komunale.

Projekti 1. Asfaltimi i rrugës Qendër – Zjarrfikës – Kosovatrans në Kamenicë.

Projekti 2. Asfaltimi i rrugës Hogosht – Kopërrnicë – Bunari i Zenelit.


Projekti 3. Asfaltimi i rrugës në mes të Karaçevës së Epërme dhe të Poshtme

Projekti 4. Asfaltimi i rrugës Shipashnicë – Poliçkë.


Projekti 5. Asfaltimi i rrugëve jo regjionale.

ANALIZA HAPESINORE

Nga shërbimi i transportit publik automobilistik përfshihen rreth 68% të vendbanimeve, ku në 54% të këtyre vendbanimeve transporti publik zhvillohet me autobus, kurse në 14% të vendbanimeve ky transport zhvillohet me kombibus (shih hartën).




Në 17 vendbanime (22% të vendbanimeve) transporti publik automobilistik zhvillohet në rrugë të pa asfaltuara (në 10 vendbanime me autobus, kurse në 7 vendbanime me kombibus). Në disa rrugë të paasfaltuara transporti është i vështirësuar e në disa të tjera gati i pamundur dhe kjo bën që ato vendbanime me këto rrugë të kenë lidhje shumë të dobëta me vendet tjera dhe në një mënyrë të jenë të izoluar. Kjo tregon se rrugët në ato vendbanime në një masë më të madhe se tjerat janë të gatshme për t'u asfaltuar dhe për këtë arsye do të duhej që në të ardhmen të jenë si prioritet për t'u asfaltuar.



Rekomandimet

Nga analiza e shtrirjes hapësinore të transportit publik (me autobus, gjegjësisht me kombibus), shihet se ai zhvillohet edhe nëpër vendbanime të cilat nuk i kanë rrugët e asfaltuara, çka do të thotë se këto rrugë duhet të jenë në prioritetet e komunës për asfaltimin dhe ngritjen e kategorisë së tyre, në mënyrë që transporti publik të jetë sa më kualitativ.

Shërbimet komunale për ujë, mbeturina dhe kanalizim kanë hy në procesin e korporatizimit dhe konsolidimit, gjatë të cilit proces, autoritetet menaxhuese kanë kaluar në nivel regjional, dhe me këtë rast komuna nuk ka kurrfarë ndikimi në zhvillimin e tyre. Infrastruktura prezent e këtyre shërbimeve është e vjetruar dhe nuk plotëson nevojat e banorëve lokal. Problemet kyçe me të cilat ballafaqohen këto shërbime janë: kapacitetet e kufizuara të burimeve të ujit të pijshëm, rrjeti i distribuimit të ujit i cili nuk është në gjendje të mirë, është i amortizuar dhe si pasojë 44.39 % e ujit të prodhuar pëson humbje teknike. Problem në vete paraqet mungesa e energjisë elektrike, që me reduktimet ekzistuese shpesh dëmton pompat dhe pajisjet tjera të rrymës. Furnizimi me ujë në komunën e Kamenicës nuk është në nivel të kënaqshëm. Nga 76 vendbanime vetëm 4 prej tyre me rreth 2000 konsumatorë furnizohen me ujë përmes ujësjellësve (qoftë me pompa apo me gravitet).





Në ujësjellës publik janë të kyçura Kamenica (1780 konsumatorë) dhe Berivojca (150 konsumatorë), ekziston edhe ujësjellësi rural në fshatin Karaçevë e Poshtme (170 konsumatorë) (KRUK "Hdromorava") dhe në Topanicë. Kapaciteti i mundshëm i prodhimit të ujit në qytet është 40 l/sec, ndërsa furnizimi i qytetarëve 19 l/sec, kurse në Topanicë kapaciteti i pompave është 6.6 l/sec njëra pompë dhe 3.6 l/sec pompa

tjetër. Sipas ekspertëve komunal kjo sasi nuk i mbulon nevojat e banorëve. Për t'u përmirësuar gjendja në këtë fushë, duhet hapur disa puse si në zonën urbane ashtu edhe në atë rurale.


Në rrjetin e kanalizimit janë të kyçur vetëm qyteti i Kamenicës dhe fshatrat Berivojcë dhe Petrovc (shih grafikonin). Problem tjetër në komunë sa i përket kësaj fushe, është edhe trajtimi i ujërave të zeza, i cili nuk bëhet në mënyrë adekuate. Shqetëson fakti se të njëjtat ujëra derdhen në lumin Krivarekë (lum ky që kalon përmes qytetit) pa u trajtuar fare.

Menaxhimi i mbeturinave të ngurta bëhet nga Kompania Regjionale "Higjiena", me seli në Gjilan, Njësia Punuese në Kamenicë. Mbeturinat hidhen në deponinë regjionale, në Malishevë të Gjilanit. Kjo deponi është 30 km larg Kamenicës, gjë që vështirëson bartjen e mbeturinave



ANALIZA HAPËSINORE

dhe ngritë koston e grumbullimit. Nga shërbimi i largimit të mbeturinave janë të përfshira vetëm 8 vendbanime (11% të vendbanimeve) ku jetojnë rreth 40% të banorëve të komunës, mirëpo në 7 prej këtyre vendbanime ky shërbim funksionon pjesërisht. (shih hartën)



Rekomandimet

Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit publik dhe qasja më e madhe e popullatës në të e sidomos në pjesët e komunës që kanë potenciale të zhvillimit (ekonomik, bujqësor, turistik, social, kulturor, shëndetësor e arsimor), e të cilat do të ndihmoheshin për zhvillim të mëtutjeshëm me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe kualitetit të jetës,

Ndërtimi i akumulacioneve ujore në Kremenatë, Desivojcë dhe Gjyrishec,

Zgjerimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza dhe qasja më e madhe e popullatës në të; ndërtimi i impiantit për përpunimin e ujërave të zeza,

Duke u bazuar në të dhënat që thonë se në Kosovë prodhohet rreth 1.2 kg mbeturina në ditë për kokë banori, dhe në anën tjetër duke e marrë parasysh shkallën e shtrirjes së këtij shërbimi në komunën e Kamenicës dhe numrin e popullatës të përfshirë nga ky shërbim, mbetet nevojë që shërbimi i largimit të mbeturinave të zgjerohet dhe nga ai të përfshihet e tërë popullata.

Prioritetet për rrjet të ujësjellësit

Deri më 2010 të rritet numri i fshatrave që do të kenë qasje në ujësjellës dhe kanalizim.

- Projekti 1. Hapja e puseve për ujë të pijes në qytet
- Projekti 2. Ujësjellësi në Muçivërc
- Projekti 3. Ujësjellësi në Rogoçicë
- Projekti 4. Ujësjellësi në Kolloleq
- Projekti 5. Ujësjellësi në Hodonoc-Kërshlant
- Projekti 6. Ujësjellësi në Koretin
- Projekti 7. Ujësjellësi në Hogosht
- Projekti 8. Ujësjellësi në Shipashnicë të Ulët
- Projekti 9. Ujësjellësi në Shipashnicë të Epërme
- Projekti 10. Ujësjellësi në Stralicë
- Projekti 11. Ujësjellësi në Domoroc
- Projekti 12. Ujësjellësi në Kopërnice
- Projekti 13. Ujësjellësi në Petroc
- Projekti 14. Ujësjellësi në Novosellë
- Projekti 15. Ujësjellësi në Dajkoc
- Projekti 16. Ujësjellësi në Karaçevë të Epërme - Selishtë

Prioritetet për rrjet të kanalizimit

- Projekti 1. Kanalizimi në Shipashnicë të Epërme.
- Projekti 2. Vazhdimi i rrjetit të kanalizimit në Rogoçicë.
- Projekti 3. Kanalizimi në Koretin - lagja e epërme
- Projekti 4. Kanalizimi në Kopërnice
- Projekti 5. Kanalizimi në Novosellë
- Projekti 6. Kanalizimi në Hogosht
- Projekti 7. Kanalizimi në Kolloleq
- Projekti 8. Kanalizimi në Karaçevë të Poshtme
- Projekti 9. Kanalizimi në Karaçevë të Epërme
- Projekti 10. Kanalizimi në Dajkoc
- Projekti 11. Kanalizimi në Topanicë
- Projekti 12. Kanalizimi në Domoroc
- Projekti 13. Kanalizimi në Stralicë
- Projekti 14. Kanalizimi në Grizime
- Projekti 15. Kanalizimi në Berivojcë
- Projekti 16. Kanalizimi në Ruboc
- Projekti 17. Kanalizimi në Hodonoc - Kërshlant.

Energjetika: Si burim energjetik për ngrohje në komunë përdoret kryesisht druri, kurse për ndriçim, industri dhe nevoja tjera shtëpiake përdoret energjia elektrike. Të gjitha vendbanimet e Komunës së Kamenicës janë të përfshira në rrjetin elektrik. Komuna e Kamenicës disponon:

- Trafostacione 10/04 kv - 140 copë;
- Largpërçues 10/ kv - 300 km;
- Largpërçues 110 kv- 10-12 km dhe
- Rrjeti i largpërçuesit të tensionit të ulët 380/220 vat

Trafostacionet shpërndarëse janë të amortizuara dhe kanë nevojë të riparohen. Shtyllat e tensionit të ulët dhe të lartë (afro 40% e tyre), janë prej drurit dhe kanë nevojë për zëvendësim të tyre me shtylla të betonit. Edhe izolatorët e rrjetit elektrik janë mjaft të dëmtuar dhe kërkojnë riparim urgjent.



ANALIZA HAPESINORE

Në i vendbanime të komunës së Kamenicës, 0–20% e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike është i dëmtuar, në 26 vendbanime ky rrjet është i dëmtuar 21– 50%, ndërsa në 39 vendbanime 70-99% e rrjetit të furnizimit me energji elektrike është i dëmtuar.

Furnizimi me rrymë elektrike në komunë nuk është i rregullt, ka restriksione me orar jo të

sigurt dhe të gjatë. E gjithë kjo pengon zhvillimin e të gjitha aktiviteteve në vend në përgjithësi, e në veçanti të atyre ekonomike.

Vendbanimet të cilat kanë tension më të dobët të rrymës elektrike janë: Hajnoci, Berivojca, Bushinca, Carakoci, Krileva, Velegllava e Poshtme dhe Epërme.



ANALIZA HAPËSINORE



Telekomunikimi (telefonja fikse dhe mobile)

Në territorin e komunës së Kamenicës ekziston rrjeti i telefonisë fikse dhe gjithashtu ky territor mbulohet edhe nga valët e telefonisë mobile. Rrjeti i telefonisë fikse ka shtrirje në 18 vendbanime me gjithsej 2852 numra.



Valët e telefonisë mobile mbulojnë plotësisht 58% të vendbanimeve të komunës ku jetojnë rreth 85% të banorëve të komunës, kurse pjesërisht mbulohen rreth 42% e vendbanimeve të komunës.

ANALIZA HAPESINORE



Rekomandimet

- Furnizimi i baraspeshuar me energji elektrike i të gjitha zonave të komunës dhe përmirësimi i rrjetit të shpërndarjes në mënyrë që mos të mbeten vendbanime me tension të dobët të rrymës elektrike;
- Shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse dhe mobile edhe në vendbanimet tjera të komunës;

ANALIZA HAPESINORE

Nga harta e më poshtme shihet se zhvillimi i përgjithshëm i infrastrukturës në komunën e Kamenicës është i ultë, ku rreth 59% e vendbanimeve gjenden nën mesataren e zhvillimit të komunës.




Në hartën e mëposhtme janë paraqitur projektet prioritare të infrastrukturës teknike në komunën e Kamenicës (zgjerimi dhe asfaltimi i rrugëve, ndërtimi i akumulacioneve ujore, rregullimi i rrejtë të ujësjellësit dhe kanalizimit).

ANALIZA HAPESINORE



ANALIZA HAPËSINORE E KOMUNËS SË KAMENICËS

Harta nr. 3 / PROJEKTET PRIORITYRE



MINISTRIA E MJEDISIT DHE E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
 MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
 MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
 Instituti për Planifikim Hapësinor - Institut za Prostornog Planiranje - Institute for Spatial Planning



Problemet dhe mundësitë

Në zhvillimin e komunës së Kamenicës, ndikimi i rrugës magjistrale në relacionin Kamenicë – Crep – Gjilan dhe Kamenic-Crep-Bujanoc në të gjitha çështjet që janë shtruar në këtë analizë hapësinore është i dukshëm. Zhvillimet e viteve të fundit, janë prezent sidomos në piken Doganore Dheu i Bardhë – Crep.

Reliefi (konfiguracioni natyror) i luginave të lumenjve Krivarekë, lumi Hogoshtë dhe Morava me tokë kualitative bujqësore dhe me mundësi ujitjeje, me infrastrukturë teknike e sociale më të zhvilluar, me komunikim dhe shërbime solide, me vendbanime më të mëdha dhe numër më të madh të banorëve, janë parakushte për një zhvillim më të shpejtë të kësaj pjese të komunës së Kamenicës e sidomos për zhvillim të bujqësisë.

Në bazë të analizave të bëra, si zona me probleme më të shprehura dhe nën mesataren e zhvillimit, janë zonat në terrenet kodrinore-malore ku nuk ekzistojnë parakushtet e përmendur më lartë. Andaj në këto zona janë më të shprehura: varfëria me shkaktarët e vet të shumtë siç janë papunësia e madhe, sipërfaqja e tokave jo kualitative bujqësore, kushtet më të pafavorshme për shtrirjen e infrastrukturës teknike, kuadri arsimor e shëndetësor më i paktë etj. Si pasojë e kësaj paraqitet dukuria e depopullimit të këtyre zonave. Ndërkaq qendra urbane e ka problemin e mbipopullimit. Për shkak të tij, hapësirat shkollore dhe të qendrës shëndetësore bëhen të pamjaftueshme.

Humbja e tokës bujqësore nga ndërtimet e pakontrolluara është një problem tjetër në komunën e Kamenicës. Nga analiza e bërë për zonën urbane del se kufiri urban është rritur në drejtim të rrugëve më të frekuentuara dhe të tokave bujqësore.

Në komunën e Kamenicës mjedisi po ndotet e po degradohet nga derdhja e ujërave të zeza dhe industriale të patrajtuara në lumenj me mundësi të depërtimit edhe në ujërat nëntokësor. Nga nxjerrja e paplanifikuar e inerteve nga lumi, hedhja pa kriter e mbeturinave në lumenj dhe brigje të tyre shkaktohet rreziku për vërshime. Prerjet ilegale të pyjeve dhe shfrytëzimi joracional i tyre kanë për pasojë përveç tjerash edhe erozionin.

Problemet dhe mundësitë që i ka komuna e Kamenicës (disa prej problemeve janë paraqitur në hartën e mëposhtme) duhet të trajtohen në mënyrë specifike në momentin e hartimit të politikave zhvillimore komunale. Në komunën e Kamenicës bartës kryesor të zhvillimit sot janë bujqësia tregtia dhe disa ndërmarrje te vogla ne industrinë e materialit ndërtimor – në Crep dhe rruga magjistrale në relacionin Kamenicë-Crep-Gjilan-Bujanoc. Si bartës të zhvillimit të ardhshëm në zonat kodrinore-malore janë resurset natyrore të përshtatshme për zhvillimin e turizmit malor, sportiv, rekreativ, shëndetësor dhe të gjuetisë. Fondi i tokave bujqësore kualitative në dy anët e luginave lumore janë bartës i zhvillimit te bujqësisë si lavërtari, pemëtari etj. Fondi i kullosave këtu ofron mundësi të zhvillimit të blegtorisë e parakushtet janë edhe për zhvillimin e bletarisë dhe gjuetisë.


Bartës i zhvillimit edhe në të ardhmen në komunën e Kamenicës do të jenë edhe resurset natyrore qe para vitit 1990 janë shfrytëzuar për kapacitetet industriale qe njëherit kanë qenë edhe bartës të zhvillimit ekonomik të komunës. Pika kufitare te Dheu i Bardhë, gjithashtu është katalizator i zhvillimit të rëndësishëm komunal.

Në bazë të analizave të bëra rekomandimet përfundimtare për potencialet e zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe shfrytëzim te mjedisit janë:

- Zhvillimi i bujqësisë-lavërtarisë (luginat e lumenjve)
- Zhvillimi i blegtorisë, bletarisë në viset kodrinoro-malore
- Zhvillimi dhe shfrytëzimi i pylltarie (rreth 27.000ha)
- Shfrytëzimi i resurseve natyrore rërë, zhavorr (të kontrolluara)
- Shfrytëzimi i pasurive natyrore të mineraleve për rimëkëmbjen i industrisë

ANALIZA HAPESINORE


- Zhvillimi i turizmit në bazë të rekomandimeve në diskutimet publike për Planin Hapësinor të Kosovës në V-L të komunës në Malin KIKA (turizëm rekreativ dhe shëndetësor)
- Mundësitë e shfrytëzimit të ujit të lumenjve për pije, ujë industrial dhe ujitje. Rekomandohet ndërtimi i tri pikave ujëmbledhëse në Kremenatë, në Gjyrishec dhe në Desivojcë që përfshin pjesën më të madhe të popullatës dhe tokave bujqësore.
- Zgjerimi i infrastrukturës rrugore Kamenicë-Crep-Bujanoc dhe Crep-Gjilan M25.3
- Hapja e rrugëve të reja dhe lidhja me shtetin fqinjë Hogoshtë-Poliqkë-Desivojcë-Tërsten-Leban (parandalimi i migrimeve)
- Lidhja me unazën e jashtme që është paraparë me Planin Hapësinor të Kosovës me rrugën Kamenicë – Krilevë-Podujevë
- Rregullimi i rrugëve kodrinoro-malore Hogoshtë-Lisockë-Gjyrishec-Gmicë-Tugjec
- Shfrytëzimi i kapaciteteve të turizmit Kulturor (Inventarizimi i tyre dhe oferta turistike)
- Shfrytëzimi i pejsazheve natyrore për turizëm rural. Mundësitë e zhvillimit të zonës industriale në trekëndëshin ekonomik në Crep për shkak të pozitës gjeografike dhe shtrirjes si region në mes 3 qendrave Kamenic-Bujanoc-Gjilan (shtrirja hapësinore: zhvillim i kontrolluar në tokat me kualitet të dobët)



► Harta: Trashëgimia kulturore dhe natyrore në funksion të zhvillimit ekonomik

ANALIZA HAPESINORE

► Harta: Zhvillimet hapësinore ne infrastrukturë dhe bujqësi



Treguesit dhe kriteret për vlerësim

1. Varfëria e lartë dhe në rritje:

Treguesit

Numri i banorëve me asistencë sociale

Numri i familjeve me asistencë sociale

Kriteri

- % e popullsisë së vendbanimit që marrin asistencë sociale:

0 - 4 % - tregon varfëri të ulët

4 - 22 % - varfëri e mesme

Mbi 22 % - varfëri e lartë

2. Papunësia e lartë dhe në rritje të vazhdueshme:

Treguesit

Numri i punëkërkuessve të paraqitur në zyrën komunale për punë dhe punësim

Kriteri

- % e të pa punëve në raport me tërë popullsinë e vendbanimit

0 - 6 % - papunësi e ulët

6 - 18 % - papunësi e mesme

Mbi 18 % - papunësi e lartë

3. Depopullimi i vendbanimeve:

Treguesit

Numri i banorëve sipas vendbanimeve në vitin 1998

Numri i banorëve sipas vendbanimeve në vitin 2003

Mesatarja e rritjes së popullsisë

Numri i personave të mbytur gjatë luftës.

Kriteri

- % e popullsisë së shpërngulur sipas vendbanimeve prej vitit 1998 deri 2003

0 - 30 % - depopullim i vogël

30 - 80 % - depopullim i lartë

Mbi 80 % - depopullim shumë i lartë

4. Shërbimet e ulëta arsimore dhe shëndetësore:

Treguesit

Objektet shëndetësore/nr. banorëve

Kuadri shëndetësor/nr. banorëve

Kuadri përkatës – kualifikimi i personelit mjekësor

Largësia e shërbimeve shëndetësore

Sipërfaqja shkollore/ nr. i nxënësve

Kuadri arsimor/ nr. i nxënësve

Kuadri përkatës – kualifikimi i mësimitdhënësve

Largësia e objekteve shkollore

Kriteret për shëndetësi:

1 mjek dhe 2 motra medicinale / 2000 banorë

1 ambullant/ 6000 banorë

1 QMF / 10 000 banorë

1 QKMF / 60 000 banorë

Kriteret për arsim:

5 m² / 1 nxënës

22 nxënës / 1 mësues

5. Degradimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore:

Treguesit

Numri i objekteve kulturo-historike

Numri i objekteve arkeologjike

Lista e objekteve (zonave) natyrore të cilat IMNK-ja i propozon për mbrojtje

Kriteret

- Numri dhe rëndësia e objekteve me trashëgimi kulturo-historike sipas vendbanimeve

6. Humbja e tokës bujqësore:

Treguesit

Sipërfaqja e tokës bujqësore në komunën e Vushtrrisë në të gjitha fshatrat

Të dhënat nga Agjencioni Kadastral i Kosovës

Kriteri

- % e sipërfaqes së tokës bujqësore sipas vendbanimeve

15 – 31 %

31 – 47 %

47 – 63 %

63 – 79 %

Mbi 79 %

7. Banimi:

Kriteri

- Merren vlerësimet e çështjeve tjera (infrastruktura, shërbimet komunale, hapësirat përcjellëse etj.), të cilat japin si rezultat kualitetin e banimit dhe të jetës në përgjithësi

8. Zonat e rrezikuara nga vërshimet dhe erozioni:

Treguesit

Të dhënat nga atlasit: Baza e hidroekonomisë së Kosovës

Të dhënat komunale për zonat e rrezikuara nga vërshimet

Kriteret:

Vendbanimet dhe sipërfaqet e tokave bujqësore të rrezikuara nga vërshimet.

Shkalla e erozionit (I, II, III, IV, V).

9 – 10. Ndotja degradimi dhe shfrytëzimi joracional i mjedisit:

Treguesit

Të dhënat komunale për ndotjen dhe degradimin e mjedisit

Të dhënat nga IHMK (Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës)

Të dhënat nga dokumenti – Strategjia e mjedisit

Raporti mbi gjendjen ambientale në Kosovë

Kriteret:

Shkalla e ndotjes në bazë të kriterëve të përcaktuara nga UE

Deponitë ilegale në vendbanime

Shkarkimi i ujërave të zeza

Vendshfrytëzimet ilegale të pasurive natyrore

11. Zhvillimi i pabarabartë ekonomik:

Treguesit

Informatat mbi organizimin e bizneseve, veprimtarit dhe numrin e të punësuarve në fshatrat e komunës së Vushtrrisë

Organizimi i bujqësisë

Potencialët turistike

Kriteret:

Numri i bizneseve dhe llojit të bizneseve për bashkësi lokale.

Numri i serave dhe lloji i tyre nëpër vendbanime

Vlerat natyrore për potencial turistik

I2. Infrastruktura dhe shërbimet:

Treguesit

Vendbanimet nëpër të cilat kalojnë rrugët e asfaltuara

Vendbanimet të cilat kanë shërbimet e transportit publik

Të dhënat për transportin hekurudhor

Të dhënat për furnizim me energji elektrike

Vendbanimet të cilat kanë rrjetin e ujësjellësit

Vendbanimet të cilat kanë rrjetin e kanalizimit dhe ujërave fekale

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në largimin e mbeturinave

Kriteret :

% e vendbanimeve të komunës të cilat i kanë rrugët e asfaltuara

% e VB-ve të komunës të cilat i kanë të organizuar shërbimet e transportit publik

% e VB-ve të komunës të cilët e kanë transportin hekurudhor

% e VB-ve të komunës të cilët e kanë rrjetin e ujësjellësit dhe % e banorëve të kyçur në të.

% e VB-ve të cilat e kanë rrjetin e kanalizimit dhe % e banorëve të kyçur në të

% e VB-ve të cilat janë të përfshira në rrjetin e grumbullimit të mbeturinave dhe % e popullsisë të përfshira në të.

Përgjegjësit nga IPH

Luan Nushi	drejtor në Institutin për Planifikim Hapësinor
Shpend Agaj	përgjegjës për Analizën Hapësinore dhe për Mjedis
Besim Gallopeni	përgjegjës për Banim
Luljeta Orana	përgjegjës për Arsim dhe Shëndetësi
Festa Nela	përgjegjës për Trashëgimi Kulturore dhe Natyrore
Riza Murseli	përgjegjës për Ekonomi dhe GIS
Mimoza Kallaba	përgjegjës për Infrastrukturë
Ismail Gagica	përgjegjës për GIS
Nexhmije Kamberi	përgjegjës për Mjedis

Bashkëpunëtorët dhe përgjegjësit nga KK - Kamenicë

Islam Thaçi	Kryeshef i Ekzekutivit
Tajar Dermaku	Koordinator për projektin nga ekzekutivi i KK - Kamenicë
Mehmet Thaqi	Drejtorati për Urbanizëm
Refik Latifi	Inspektorati për Mjedis dhe
Drejtoratet tjera komunale	